

## GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

P.Kr. 135/15

Data: 11 nëntor 2015

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në GJILAN përmes trupit gjykues të përbërë nga Kryetari i trupit gjykues i EULEX-it Vitor Hugo Pardal, gjyqtari i EULEX-it Radostin Petrov dhe gjyqtari vendor Kosovar Afrim Shala si anëtarë të trupit gjykues dhe procesmbajtësi Muhamet Musliu, në rastin penal kundër:

**L .J.**, me nofkën N, i biri i xxx dhe xxx, i lindur me xxxx, mashkull, banor në XXX, Kosovë, Shqiptar i Kosovës dhe me nënshtetësi të dyfishtë, edhe të Kosovës edhe të Serbisë, kjo e fundit me numër të ID-së xxxx dhe me numër pasaporte xxx, në paraburgim që nga data 10 janar 2014;

Akuzuar me veprat penale të dhëna si më poshtë dhe sipas aktakuzës:

(1) **Tentim vrasje e rëndë** – dy pika të akuzës, në kundërshtim me nenin 147 paragrafët 4, 5, 6 dhe 10 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) i vitit 2003, në lidhshmëri me nenin 20 të KPK-së, e dënueshme me burgim prej jo më shumë se tre të katërtat e dhjetë vjet ose burgim afatgjatë - pikat 1 dhe 6;

(2) **Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare** – dy pika të akuzës, në kundërshtim të nenit 317 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së, e dënueshme me burgim prej një e deri në dhjetë vjet– pikat 4 dhe 8;

(3) **Lëndim i rëndë trupor** – një pikë e akuzës, në kundërshtim të nenit 154 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së, e dënueshme me burgim prej një e deri në dhjetë vjet – pika 2;

(4) **Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** – dy pika të akuzës, në kundërshtim të nenit 328 paragrafët 1, 2, 3 të KPK-së – pikat 5 dhe 9;

Pas mbajtjes së 12 seancave publike gjyqësore, respektivisht me 6 shkurt 2015, 13 shkurt 2015, 20 prill 2015, 21 prill 2015, 21 maj 2015, 22 maj 2015, 24 korrik 2015, 27 korrik 2015, 24 gusht 2015, 29 shtator 2015, 16 tetor 2015 dhe 9 nëntor 2015, dhe i shpallur me datë 11 nëntor 2015 në prani të të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës R.G., si dhe në prani të Prokurorit të PSRK-së Z. Andrew Carney, pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit nga ana e trupit gjykues me datë 9 nëntor 2015, në bazë të neneve 362.1, 364 dhe 365 të KPPK-së, lëshon si në vijim

## AKTGJYKIM

**Sipas pikës 1 – Tentimi për të kryer vrasje të rëndë në bashkëkryerje,** në kundërshtim të nenit 147, paragrafët 4, 5 dhe 10 në lidhshmëri me nenet 20 dhe 23, të tërë KPK-së së vitit 2003, në bazë të neneve 362.1 dhe 364.1.3 të KPPK-së, i akuzuari **L J**

### LIROHET

Nga akuza e sipërpërmendur, sepse në rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën ai është akuzuar, si në vijim:

*“me datë 15 shtator 2004, për afërsisht në ora 01:50, në afërsi të rrugës xxx, , Shkup, në Republikën e Maqedonise , L J, në bashkë-kryerje me një person tjetër, ka gjuajtur një numër të shtënash duke e përdorur pistoletën e tipit “T” me kalibër 7.62 x 25mm, me numër serik P... ndaj zyrtarëve policor në uniformë Z A, V I dhe E D, gjersa ata ishin duke vozitur përgjatë asaj rruge, në patrullë, në një makinë L të policisë dhe me shenja të policisë, me numër regjistrimi xxx. Të gjithë zyrtarët policorë kanë pësuar lëndime të rënda në formë të plagëve nga armë zjarri si rezultat i sulmit në makinën e tyre gjersa ata kanë qenë të ulur në të. Në të shtënash që janë bërë kundër tre zyrtarëve policorë, L J ka tentuar që ti privojë nga jeta zyrtarët policorë, në rrethanat e dhëna si në vijim: ai qëllimisht ka rrezikuar jetën e një apo më shumë personave gjersa ka vepruar mizorisht dhe në mënyrë të dhunshme dhe në kohën kur të tre zyrtarët policorë ishin duke i kryer detyrat e tyre të mbrojtjes së rendit dhe ligjit, duke i zbuluar veprat penale, duke ndaluar një kryes të një vepre penale dhe duke qenë në ruajtje të rendit publik dhe qetësisë”.*

**Sipas pikës 2 – Lëndim i rëndë trupor në bashkë-kryerje,** në kundërshtim të nenit 154, paragrafët 1 dhe 2 në lidhshmëri me nenin 23, që të dyja të KPK-së së vitit 2003, në bazë të neneve 362.1 dhe 364.1.3 të KPPK-së, i pandehuri **L J**

### LIROHET

Nga akuza e referuar më sipër, sepse në rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën ai është akuzuar, si në vijim:

*“me datë 15 shtator 2004, për afërsisht në ora 01:50, në afërsi të rrugës xxx, Shkup, në Republikën e Maqedonise M, L J, në bashkë-kryerje me një person tjetër, ka gjuajtur një numër të shtënash duke e përdorur pistoletën e tipit “T” me kalibër 7.62 x 25mm, me numër serik P... ndaj zyrtarëve policor në uniformë Z A, V I dhe E D, gjersa ata ishin duke vozitur përgjatë asaj rruge, në patrullë, në një makinë L të policisë dhe me shenja të policisë, me numër regjistrimi xxx. Si rezultat i këtij sulmi ndaj tyre, i pandehuri ka shkaktuar lëndime trupore mbi ta gjer në atë masë sa që ka mundur të rezultojë në rrezikimin e jetës së tyre . Më tej, V I është lënduar gjer në atë masë sa që vepra në mënyrë të përhershme dhe të rëndë ia ka dëmtuar shëndetin si dhe në mënyrë të përhershme ia ka dëmtuar një organ vital, ose pjesë vitale të trupit të tij, ashtu që shpretkë e tij është dashur që të hiqet si dhe një pjesë e zorrës së tij të vogël, ndërsa plumbi ka ngecur afër mëlçisë së tij. E D është lënduar gjer në atë masë ashtu që kjo vepër asaj ia ka dëmtuar në mënyrë të përhershme dhe të rëndë shëndetin duke ia shkatërruar një organ vital të trupit të saj apo një pjesë vitale të trupit të saj, me ç’rast e shtëna në gishtin e saj ka shkaktuar që ajo ta humbasë funksionim normal të dorës së saj të majtë”.*

**Sipas pikës 4 – Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në bashkë-kryerje**, në kundërshtim të nenit 317, paragrafët 1 dhe 3 në lidhshmëri me nenin 23, që të dyja nga KPK e vitit 2003, në bazë të neneve 362.1 dhe 364.1.3 të KPPK-së, i pandehuri **L J**

#### **LIROHET**

Nga akuza e sipërpërmendur, sepse në rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar, si në vijim:

*“me datë 15 shtator 2004, për afërsisht në ora 01:50, në afërsi të rrugës xxx, Shkup, në Republikën e Maqedonise, L J, në bashkë-kryerje me një person tjetër, ka gjuajtur një numër të shtënash duke e përdorur pistoletën e tipit “T” me kalibër 7.62 x 25mm, me numër serik P ndaj zyrtarëve policor në uniformë Z A, V I dhe E D, gjersa ata ishin duke vozitur përgjatë asaj rruge, në patrullë, në një makinë L të policisë dhe me shenja të policisë, me numër regjistrimi 2-2. Duke vepruar në këtë mënyrë, ai ka sulmuar persona zyrtarë të cilët kanë qenë duke i performuar detyrat zyrtare që kanë të bëjnë me sigurinë publike dhe ruajtjen e rendit publik. Të gjithë zyrtarët policorë kanë pësuar lëndime të rënda trupore përmes plagëve të shkaktuara me armë zjarri si rezultat i sulmit mbi makinën e tyre”.*

**Sipas pikës 5 – Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në bashkë-kryerje**, në kundërshtim të nenit 328, paragrafët 1 dhe 2 në lidhshmëri me nenin 23, që të dyja të KPK-së së vitit 2003, në bazë të neneve 362.1 dhe 364.1.3 të KPPK-së, i pandehuri **L J**

#### **LIROHET**

Nga akuza e sipërpërmendur, sepse në rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar, si në vijim:

*“me datë 15 shtator 2004, për afërsisht në ora 01:50, në afërsi të rrugës xxxx, Shkup, në Republikën e Maqedonise, L J, në bashkë-kryerje me një person tjetër, ka gjuajtur një numër të shtënash duke e përdorur pistoletën e tipit “T” me kalibër 7.62 x 25mm, me numër serik P ndaj zyrtarëve policor në uniformë Z A, V I dhe E D, gjersa ata ishin duke vozitur përgjatë asaj rruge, në patrullë, në një makinë L të policisë dhe me shenja të policisë, me numër regjistrimi xxx Në kohën kur ai e ka përdorur armën e tij, ai e ka përdorur pa pasur një kartelë autorizimi valide për të”.*

**Sipas pikës 6 – Tentim vrasje e rëndë**, në kundërshtim të nenit 147, paragrafët 10 dhe 11 në lidhshmëri me nenet 15.3 dhe 20, të gjitha KPK të vitit 2003, në bazë të neneve 362.1 dhe 365.1 të KPPK-së, i akuzuari **L J**, shpallet

#### **FAJTOR**

Në lidhje me akuzën e sipërpërmendur, sepse në rastin konkret, është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën ai është akuzuar, si në vijim:

*“me 24 dhjetor 2004, për afërsisht në ora 20:30 në objektin e njohur si apartamenti xxx, rruga xxx, Tetove, Republika e Maqedonise, një numër zyrtarësh policorë nga njësi speciale e policisë, përgjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare, kanë hyrë në objekt me qëllimin e ligjshëm për ta arrestuar L J, i cili i nënshtrohej një urdhër arresti. Gjersa ata hynin në banesën e pa mbyllur me qelës, nga dera kryesore, dhe duke pas bërë titur paralajmërimin se ata ishin zyrtarë policorë dhe se banorët duhet të ndalonin dhe të ngisnin duart, L J, pas asnjë arsye ligjore të justifikueshme apo mbrojtje të ligjshme, ka gjuajtur së paku 6 të shtëna në drejtim të së paku 2 zyrtarëve policorë, duke e përdorur pistoletën e tipit “T” me kalibër 7.62 x 25mm, me numër serik P, nga grumbulli i armëve të cilat ai dhe Xh Sh i kishin sjellë në objekt, e cila po ashtu përfshinte një armë gjysmë automatike C Z M92, me kalibër 7.62 x 39m, numër serik 7..., një granatë-hedhës MGL kalibër 40mm me numër serik të paidentifikuar me që ishte fshirë dhe një pushkë gjysmë automatike e paidentifikuar e kalibrit 7.62 x 39mm. Po ashtu i pranishëm në banesë me L J ishin edhe V A, F S, L D dhe Xh Sh. Njëri nga zyrtarët, dëshmitari “E” që qëlluar dhe kishte pësuar lëndime të rënda nga gjuajtjet me armë zjarri nga një gjuajtje prej një burimi të paidentifikuar. Në gjuajtjen me armë në drejtim të së paku dy zyrtarëve policorë, L J ka tentuar që ti privojë ata nga jetët e tyre, kështu që ai ka qenë i vetëdijshëm se mund të vijë gjer tek vdekja si një pasojë e ndaluar*

*e veprimeve të tija dhe megjithatë ai ka vazhduar me këtë veprim. Ai veproi në një kohë kur zyrtarët policorë ishin duke i ekzekutuar detyrat e tyre për mbrojtjen e rendit ligjor, zbulimin e veprave penale, kapjen e kryesit të veprës penale, dhe mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike”.*

**Sipas pikës 8 - Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në bashkë-kryerje**, në kundërshtim të nenit 317, paragrafët 1 dhe 3 në lidhshmëri me nenin 23, të dyja të KPK-së të vitit 2003, në bazë të neneve 362.1 dhe 364.1.1 të KPPK-së, i pandehuri **L J**

#### **LIROHET**

Nga akuza e sipërpërmendur, sepse në rastin konkret vepra me të cilën i akuzuari akuzohet nuk përmban një vepër penale AUTONOME meqë ishte konsideruar si e KONSUMUAR nga vepra penale e dhënë në pikën 6, si në vijim:

*“me 24 dhjetor 2004, për afërsisht rreth orës 20:30 në objektin e njohur si apartamenti xxx, rruga xxx, Tetovë, Republika e Maqedonise, një numër zyrtarësh policorë nga njësisia speciale e policisë, ndërsa vepronin në kuadër të detyrës së tyre zyrtare, hyrën në ndërtesë me qëllimin e ligjshëm të arrestimit të L J, i cili i nënshtrohej një urdhër arresti. Duke hyrë në banesën e pambyllur me qelës, nga dera e përparme, nga pushimorja, dhe duke pas bërë titur paralajmërimet se ata ishin zyrtarë policorë dhe se banorët duhej të ndalonin dhe ti ngisnin duart lart, L J, pa asnjë arsytim ligjor apo mbrojtje të ligjshme ka gjuajtur së paku 6 të shtëna zjarri në drejtim të së paku 2 zyrtarëve policorë, duke e përdorur një pistoletë të tipit “T” kalibër 7.62 x 25mm, me numër serik P... nga grumbulli i armëve që ai dhe Xh Sh i kishin sjellë në objekt, e cila po ashtu përfshinte një pushkë gjysmë automatike C Z M92, me kalibër 7.62 x 39mm, me numër serik 7., një granata-hedhës MGL kalibër 40mm me numër serik të paidentifikuar meqë ishte fshirë dhe një pushkë gjysmë automatike të paidentifikuar 7.62 x 39mm. L J ka sulmuar persona zyrtarë të cilët ishin duke i kryer detyrat zyrtare në lidhje me sigurinë publike dhe ruajtjen e rendit publik. Njëri nga personat zyrtarë, dëshmitari “E” që qëlluar dhe ka pësuar lëndime të rënda trupore në formë të plagëve të shkaktuara nga një armë zjarri nga një burim i paidentifikuar”.*

**Sipas pikës 9 – Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në bashkë-kryerje**, në kundërshtim të nenit 328, paragrafët 1, 2 dhe 3 në lidhshmëri me nenin 23, që të dyja nga KPK e vitit 2003, sipas neneve 362.1, 363.1.3 dhe 364.1 të KPPK-së, i pandehuri **L J**

#### **LIROHET**

Nga akuza e sipërpërmendur, sepse në lidhje me Akuzën nën nenin 328.1 KPK,

në rastin konkret vepra me të cilën i akuzuari akuzohet nuk përbën një vepër penale AUTONOME, meqë pjesërisht ishte konsideruar si e KONSUMUAR nga vepra penale nën pikën 6 të akuzës (neni 364.1 KPK), dhe në lidhje me akuzën nën pikën 328.3 KPK, sepse në rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me një " sasi të madhe armësh" ashtu siç ishte akuzuar.

Akuza nën nenin 328.2 CCK është

### **REFUZUAR**

Meqë në tërësi mbulohet nga amnistia.

Faktet në lidhje me akuzën e lartpërmendur janë si më poshtë:

*"me 24 dhjetor 2004, për afërsisht në ora 20:30 në vendin e njohur si banesaxxx, rruga xxx, Tetove, Republika e Maqedonise, L J ka përdorur së paku një pistoletë të tipit "T" me kalibër 7.62 x 25mm, numër serik P..., nga shumëllojshmëria e armëve që ai dhe Xh Sh e kishin sjellë në banesë, e cila po ashtu përfshinte një pushkë gjysmë automatike C Z M92, të kalibrit 7.62 x 39m, me numër serik 7, një granatë-hedhës MGL të kalibrit 40mm me numër serik të paidentifikuar meqë ishte fshirë dhe një pushkë gjysmë automatike të paidentifikuar të kalibrit 7.62 x 39mm. Në kohën kur ai e ka përdorur pistoletën "T" dhe ka pasur në posedim armët e tjera në bashkëkryerje, ai ka vepruar në këtë mënyrë pa pasur ndonjë kartë autorizimi valid për to".*

### **DËNIMI**

Sipas nenit 365.1 të KPPK-së, dhe neneve 20, 34 to 36, 38, 64 dhe 65.2 të KPK-së së datës 2003, i pandehuri **L J** me anë të kësaj dënohet për **Pikën 6 – Tentim për të kryer vrasje të rëndë**, në kundërshtim me nenin 147, paragrafët 10 dhe 11, sipas neneve 362.1 dhe 365 të KPPK-së, në dënimin prej **6 (gjashtë) viteve burgim**;

Nga dënimi i dhënë këtu, do të zbritet koha e kaluar në paraburgim, konkretisht nga data 10 janar 2014.

### **SHPENZIMET**

L J është gjetur fajtor me një vepër penale, dhe prandaj është i obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 451.1 dhe 2 dhe 453.1 të KPPK-së, ashtu siç janë dhënë në nenin 450.2 të po të njëjtit Kod, përpos shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit përgjatë procedurave

penale. Duke pasur në konsiderim të gjitha që janë thënë më sipër, Gjykata, me anë të kësaj përcakton shumën prej 500 (pesë qind) Eurosh (neni 450.2.6 KPPK) dhe një aktvendim i veçantë do të lëshohet më tej në lidhje me shumën e tërësishme të shpenzimeve të gjykatës, duke konsideruar atëherë numrin total të dëshmitarëve, numrin e seancave të mbajtura dhe kërkesat për NJN (ILA) për të cilat ai është po ashtu përgjegjës ( neni 451.2 KPPK).

### **KËRKESAT PËR KOMPENZIM**

ASNJË kërkesë për kompensim nuk është paraqitur në këtë rast dhe nuk ka elemente të dokumentuara në dosjen e rastit për të siguruar se palët e dëmtuara nuk ishin veç kompensuar në një rast të ngjashëm që veç është gjykuar në Maqedoni. Në pamundësi për të kontrolluar nëse shuma e tërësishme që i atribuohet dëmit të pësuar qe kompensuar apo nuk është kompensuar, dhe në cilën pjesë, Gjykata drejton palët e dëmtuara që të kërkojnë kompensim për dëmet e tyre përmes shkallës civile; përndryshe ky gjykim, ku i pandehuri është në paraburgim për pothuajse dy vjet, do të ishte vonuar në mënyrë të konsiderueshëm në aktgjykimin e saj.

### **ARSYETIMI**

#### **Sfondi procedural**

Me 21 nëntor 2014, prokurori i PSRK-së Z. Andrew Carney ka parashtruar një aktakuzë kundër të akuzuarit L J i. Në mënyrë për t'i mbështetur Akuzat e sipërpërmendura, Prokurori i PSRK-së paraqiti një listë të provave teknike/dokumentare (vendi i krimit dhe gjësendet e marra duke përfshirë njollat e gjakut dhe raportet pasuese balistike dhe të ADN-së si dhe testin nitrat dhe autopsinë e L D , në faqet 11, 13, 14 deri në 16, të dhëna në tërësi në faqet 28 deri në 40) si dhe propozimi i 21 dëshmitarëve, 17 të atyre nën regjimin e anonimitetit dhe deklaratës përkatëse të sigurohet përmes video-lidhjes nga M (faqe 23).

Edhe pse i pandehuri fillimisht ai ka qenë i akuzuar me 9 pika të akuzës, pas mbajtjes së seancës së parë fillestare me datë 3 dhjetor 2014, Kryetari i trupit gjykues i hedh

poshtë dy prej tyre (pikat 3 dhe 7) përmes një aktvendimi të datës 5 janar 2015. Ky aktvendim nuk është sfiduar nga asnjë ankesë.

Ky shqyrtim kryesor është mbajtur në 12 seanca publike respektivisht me datë 6 shkurt 2015, 13 shkurt 2015, 20 prill 2015, 21 prill 2015, 21 maj 2015, 22 maj 2015, 24 korrik 2015, 27 korrik 2015, 24 gusht 2015, 29 shtator 2015, 16 tetor 2015 dhe 9 nëntor 2015. Përgjatë rrjedhës së seancave gjyqësore të sipërpërmendura, 17 dëshmitarë anonim (4 të sugjeruar fillimisht ishin tërhequr më vonë nga Prokuroria) janë marrë në pyetje përmes video-linkut nga M dhe 2 të tjerët të sugjeruar nga mbrojtja (që të dy më vonë i ka tërhequr, mirëpo, përmes një vendimi ex-officio të trupit gjykues) janë marrë në pyetje në sallën e gjyqit. Po ashtu të gjitha provat teknike/te dokumentuara të dhëna në aktakuzë janë ekzaminuar para trupit gjykues në përputhje me si dhe në çfarë mënyre që-palët i kanë konsideruar të nevojshme.

Këshillimi dhe votimi i shqyrtimit të trupit gjykues u mbajt me datë 9 nëntor 2015 dhe aktgjykimi që shpallur gojarisht gjatë seancës së fundit publike me datë 11 nëntor 2015.

Disa çështje paraprake të natyrës procedurale ishin ngritur nga mbrojtja në seancën e parë dhe më pas ato të cilat janë konsideruar dhe të vendosura në vendimin e datës 5 Janar 2015, dhënë nga kryetari i trupit gjykues. Pranueshmëria e kundërshtuar e 2 deklaratave të marra nga të dyshuarit në procedurë të mëparshme penale që vendosur me vendimin e lartpërmendur me 5 janar 2015, por u ngrit përsëri gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor kur ata të dyshuar janë marrë në pyetje si dëshmitarë gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor. Edhe pse ky kundërshtim është vendosur sërish në të njëjtën linjë, do meritojë disa zhvillime ligjore në këtë aktgjykim, vetëm për çështje të qartësimit.

I pandehuri ka nxjerrë një deklaratë gjersa merrej në pyetje në gjykim, në përputhje me nenin 346 të KPPK-së.

Prokurori i PSRK-së mbajti fjalën e tij përfundimtare dhe i pandehuri e ka dhënë fjalën përfundimtare vetë dhe u dha nga avokati i tij mbrojtës.

I pandehuri ishte i pranishëm gjatë shpalljes më gojë të aktgjykimit përfundimtar.



## **Juridiksioni i kësaj Gjykate**

Gjyqtarët që përbëjnë këtë panel janë kompetent për të vendosur në këtë rast, duke pasur juridiksionin material dhe territorial, sipas neneve 25 dhe 29 të KPPK-së; Pas vendimit të kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it, të lëshuar më 25 nëntor 2014, për të caktuar gjyqtarët e poshtë nënshkruar të EULEX-it për gjykimin e këtij rasti, dhe gjyqtari vendor u emërua sipas orarit në fuqi në Gjykatën Themelore të Gjilanit. Dymbëdhjetë seanca të shqyrtimit kryesor janë mbajtur dhe nuk ka kundërshtime që janë ngritur nga palët. Kështu që, trupi gjykues është kompetent.

### **Çështja e mëparshme: "Përdorimi në shqyrtimin gjyqësor në fjalë të deklaratave të mëparshme të dhëna nga 2 të dyshuar në një çështje që përfshin të njëjtat fakte tashmë të gjykuara në Maqedoni"**

Sipas nenit 123, paragrafi 5 KPPK, "*Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse të dhëna vullnetarisht dhe pa detyrim, janë të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo bashkë të pandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si të vetme apo si një dëshmi vendimtare fajësuese për dënim*".

Në rastin në fjalë, V A (me datë 25 dhjetor 2004) dhe F S i (me 25 dhe 27 dhjetor 2004) janë marrë në pyetje si të pandehur në M në procedura të ndara. Sidoqoftë, vetëm marrja në pyetje e F S me datë 25 dhjetor 2004 është mbajtur në prani të avokatit të tij mbrojtës.

Neni 123 KPPK i artikuluar në lidhshmëri me nenin 151, paragrafi 1, definon dhe parasheh përdorimin në intervistat e trupit gjykues dhe dëshmitë paraprake të zgjatura edhe tek i pandehuri.

Që të dyja intervistat paraprake dhe dëshmitë paraprake mund të përdoren në shqyrtimin kryesor, edhe pse vetëm nën kushte të posaçme dhe me qëllim të specifikuar në neni 123, paragrafët 2 dhe 3 të KPPK-së). Megjithatë, pranueshmëria e përdorimit të provave të mbledhura më parë për qëllime të sqarimit nga njëra anë,

dhe pranueshmëria e përdorimit të saj si dëshmi fajësuese nga ana tjetër, janë çështje krejtësisht të ndryshme.

Neni 125, paragrafi 5 KPPK është i çartë se deklaratat e mëparshme të dhëna nga një i pandehur nuk mund të përdoren "SI PROVA KUNDËR" një bashkë-të pandehuri. Është një çështje e të përdorurit të saj PËR INKRIMINIM, e jo përdorimi i saj vetëm për sqarim të deklaratave të mëtejme të dhëna direkt para trupit gjykues gjersa merret në pyetje si dëshmitar. Deklaratat e dhëna nga këta dy dëshmitarë, gjersa janë mbledhur më parë gjersa kanë qenë nën statusin e të pandehurve në Maqedoni në vitin 2004, nuk kanë mundur, nuk do të dhe nuk janë konsideruar si prova kundër të pandehurit në këtë rast, L J . Por përkundrazi – ashtu siç do sqarohet më vonë – e vetmja provë e konsideruar nga trupi gjykues në këtë rast kanë qenë deklaratat e tyre direkt të dhëna para shqyrtimit kryesor si dëshmitarë, në lidhje me të cilën trupi gjykues po ashtu ka konsideruar faktin relevant se ata kanë qenë të etiketuar më parë si të pandehur në një fazë fillestare, por më vonë, asnjëherë të akuzuar ose të gjykuar për ato fakte. Për më tepër, për të vlerësuar nëse ato deklarata paraprake si të pandehur janë në favor ose kundër të pandehurit të tanishëm, paneli duhet që t'i përdori së pari ato në gjykim. Në fakt, deklaratat e mëparshme kanë një përdorim shumë të kufizuar në përputhje me nenin 123, paragrafi 2 dhe 3 i KPPK-së dhe vetëm për sqarim; për më tepër, në fund të fundit, teorikisht ato mund të zbulohen si të favorshme për të pandehurin e tanishëm dhe jo kundër tij, duke pasur parasysh se neni 123, paragrafi 5 i KPPK-së vetëm e ndalon përdorimin e tyre KUNDËR të pandehurit vetëm për qëllime fajësuese.

Duke pasur parasysh ato që janë sqaruar këtu, trupi gjykues nuk e ka përjashtuar përdorimin linear të deklaratave të mëparshme të dëshmitarëve gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor dhe e ka pranuar përdorimin e tyre për sqarim të deklaratave të tyre aktuale të dhëna para trupit gjykues. Nëse ato e zbulojnë veten të jenë kundër të pandehurit aktual, ato asnjëherë nuk do të përdoren si dëshmi inkriminuese, duke respektuar në tërësi nenin 123, paragrafin 5 KPPK. Por, ato nuk e kanë megjithatë.

## Provat e administruara

Tërësia e mëposhtme e provave u konsiderua si relevante për shqyrtimin përfundimtar dhe aktgjykimin pasues.

Ekspozitat e shkruara: Lista e provave të dokumentuara si në vijim që konsideruar si e analizuar në shqyrtimin kryesor, ashtu siç është dhënë nga neni 344.1 KPPK:

- Raportet mjekësore të Z A 't– Lidhësja I, fq. 10-15;
- Raportet mjekësore të V I 't - Lidhësja I, fq. 28-42;
- Raportet mjekësore të E D 's - Lidhësja I, fq. 52-69;
- Shënim zyrtar – të dhënat mbi gjurmët dhe objektet e gjetura nga bastisja e vendit të krimit në vend, Përmbajtja dhe foto albumi i vendit të krimit- Lidhësja I, fq. 70-106;
- Shënim zyrtar - Lidhësja I, fq. 107-109;
- Raporti mbi ekzaminimin e armëve të zjarrit – Lidhësja I, fq. 119-121;
- Raporti i Ekspertizës 793/2004– Lidhësja I, fq. 122-146;
- Rruga, ndërtesa dhe plani i banesave –Lidhësja III, fq. 1-9;
- Dokumenti i bastisjes i Interpolit– Lidhësja III, fq. 1-9;
- Të dhënat nga përshkrimi i vendit të krimit – lidhja III, fq. 10-21;
- Procesverballi i gjurmëve të gjetura dhe sendeve nga bastisja e vendit të ngjarjes dhe foto albumi i vendit të ngjarjes – Lidhësja III, fq. 22-209;
- Raporti mbi ekzaminimin e armëve të zjarrit – Lidhja III, fq. 210-215;
- Analizat e armëve të zjarrit dhe provat mbi shkarkimin e armëve të zjarrit – Lidhja III, fq. 216-219;
- Ekspertiza e armëve të zjarrit 1178/04, gjurmët e armëve të zjarrit dhe gjurmët e origjinës biologjike –Lidhja III, fq. 220-246;
- Raporti mbi analizën e armëve të zjarrit – Lidhja III, fq. 247-252;
- Raporti i forenzikës mbi analizën e gjurmëve të armëve të zjarrit - Lidhja III, fq. 253-261;
- Shënim zyrtar 1126/2014 në lidhje me shkuarjen në vendin e krimit - Lidhja III, fq. 262-265;
- Raport mbi analizën e fletë pluhurit dhe e përcaktimit të llojit të gjakut - Lidhja III, fq. 266-268;

- Verifikimi mbi gjësendet e konfiskuara përkohësisht - Lidhja III, fq. 269-274;
- Ekspertiza 1207/2004 e gjurmëve të armëve të zjarrit dhe gjurmëve të gjakut - Lidhja III, fq. 276-283;
- Raporti I autopsisë i L D - Lidhja III, fq. 284-304;
- Foto albumi - Lidhja IV, fq. 1-11;
- Dorëzimi dhe përmbledhja e dosjes mjekësore të L J – Lidhja IV, fq. 12-15;
- Përmbajtja e dosjes mjekësore të L J - Lidhja IV, fq. 16-101;
- Flete lëshimi nga spitali me Epikrizë - Lidhja IV, fq. 102-109;
- Foto Albumi - Lidhja IV, fq. 167-169;
- Aktgjykimi nga gjykata në T – Lidhja V, fq. 1-9;
- Raporti në lidhje me marrjen e mostrës së AND-së të L J 't – Lidhja V, fq. 128-137;
- Vendimi mbi ekzaminimin forenzik: Identifikimi i AND-së dhe Analizat Molekulare dhe Gjenetike – Lidhja V, fq. 144-159;
- Raporti mbi letrën e dorëzimit rreth ADN-së – Lidhja V, fq. 163-166;
- Përgjigje për MLA Nga M – Lidhja V, fq. 167-198;
- Përgjigje për MLA Nga M – Lidhja VI, fq. 78-90;
- Urdhri për mbrojtjen e dëshmitarit – Lidhja VI, fq. 176-187;
- Përgjigje për MLA Nga M – Lidhja VI, fq. 217-218;

Dëshmitarët: deklaratat e dhëna në shqyrtimin kryesor nga dëshmitarët:

- Z A , V I , E D përmes video-linkut nga Sh , M ;
- Dëshmitarët A, B, M, C, E, F, G, R, I, J, L, P dhe Q, këta nën statusin e dëshmitarëve anonim përmes video-linkut nga Sh, M ; dhe
- A K , V A dhe F S .

Deklarata e të pandehurit: ashtu siç është paraqitur para Gjykatës në shqyrtimin kryesor.

Të gjitha të dhënat nga deklaratat e mbledhura më parë të dëshmitarëve si dhe mbështetja e pohimit në lidhje me të pandehurin ashtu siç janë dhënë në aktakuzë,

janë përdorur vetëm nën shkallën e kufizuar ashtu siç lejohet nga neni 123, paragrafët 2,3 dhe 5 të KPPK-së e jo si prova, ashtu si në verbatim të përskuara në procesverbal.

Të gjitha dokumentet tjera të dhëna në aktakuzë janë vlerësuar në mënyrë të saktë nga trupi gjykues dhe janë konsideruar si jo-relevante si dëshmi për aktgjykimin aktual.

## **Arsyetimi**

Në lidhje me bazën faktike dhe analizat përkatëse, gjetjeve dhe arsyetimit, rasti i tanishëm është i ndarë këtu - për qëllime të rrepta analitike - në 2 kapituj të veçantë: e para në lidhje me situatën e Sh , që ka ndodhur me datë 15 shtator 2004, për të cilat janë Pikat e akuzës të lidhura 1 , 2, 4 dhe 5; dhe situata në T , që ka ndodhur më 24 dhjetor 2004, për të cilat janë Pikat e lidhura 6, 8 dhe 9 të aktakuzës. Prandaj,

*A) Situata në Sh – 15 shtator 2004: Pikat 1, 2, 3 dhe 5 të aktakuzës*

### Bazat faktike:

*a. Faktet relevante si në vijim janë konsideruar si të PROVUARA:*

- 1. Me 15 shtator 2004, përafërsisht në ora 01:50, në afërsi të rrugës xxx , Shkup , në Republikën e Maqedonise , një numër i papërcaktuar i individëve, identiteti i të cilëve nuk ka mundur që të përcaktohet, duke vepruar në bashkë-kryerje, kanë shtënë një numër të shtënash duke përdorur një pistoletë të tipit "T " të kalibrit 7.62 x 25mm, me numër serik P... kundër zyrtarëve policorë të uniformuar Z A , V I dhe E D , gjersa ata ishin duke vozitur përgjatë rrugës, duke qenë në patrullë, në një makinë të tipit L me shenja të policisë, me numër regjistrimi 2 -2 .*
- 2. Të gjithë zyrtarët kanë pësuar lëndime të rënda në formë të plagëve të shkaktuara nga armë zjarri si rezultat i sulmit ndaj makinës së tyre gjersa ata kanë qenë të ulur brenda në makinë. Duke shtënë mbi tre zyrtarët policorë, individët e sipërpërmendur kanë tentuar që t'i privojnë nga jeta zyrtarët*

policorë duke i rrezikuar me qëllim jetët e një apo më shumë personave në një kohë kur që të tre zyrtarët policorë ishin duke i ekzekutuar detyrat e tyre të mbrojtjes së rendit të ligjit dhe mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike.

3. *V I* qe lënduar gjer në atë masë sa që sulmi ia ka dëmtuar rëndë dhe në mënyrë të përhershme shëndetin e tij si dhe ia ka dëmtuar në mënyrë të përhershme një organ vital apo një pjesë vitale të trupit të tij, ashtu që, shpretka e tij është dashur që të hiqet si dhe një pjesë e zorrës së tij të hollë, gjersa një plumb ka mbetur afër mëlçisë së tij.
4. *E D* është lënduar në atë masë sa që sulmi ia ka dëmtuar rëndë dhe në mënyrë të përhershme shëndetin e saj, se ia ka shkatërruar në mënyrë të përhershme një pjesë vitale të trupit të saj, ashtu që, një e qëlluar në gishtin e saj ka shkaktuar që ajo ta humbasë funksionimin e duhur të dorës së saj të majtë.
5. Me datë 24 dhjetor 2004 një pistoletë e tipit "T" e kalibrit 7.62 x 25mm, me numër serik P... ka qenë në posedim të, dhe është gjuajtur nga, L J brenda xxx , Tetove , Republika e Maqedonise , nga grumbulli i armëve që ai dhe Xh Sh i kishin sjellë në objekt një ditë më parë.

b. Faktet relevante si në vijim janë konsideruar si të PA PROVUARA:

6. Se L J ka qenë ndonjëri nga individët, i cili, duke vepruar në bashkë-kryerje, me datë 15 shtator 2004, për afërsisht në ora 01:50, në afërsi të rrugës XXX, në Republikën e Maqedonise , ka gjuajtur një numër të shtënash duke e përdorur pistoletën e tipit "T" të kalibrit 7.62 x 25mm, me numër serik P... ndaj zyrtarëve të uniformuar policor Z A , V I dhe E D , gjersa ata ishin duke vozitur përgjatë rrugës, duke qenë në patrullë, në një makinë të tipit L me shenja të policisë, me numër regjistrimi 2 -2.
7. Se L J më parë e kishte marrë – ose që nuk e kishte marrë – pistoletën T nga Xh Sh , siç qe dhënë më parë nga A K në K, M .

Arsyetimi dhe gjetjet:

Në lidhje me faktet siç janë përshkruar më sipër, deklaratat absolutisht të qëndrueshme të siguruara nga zyrtarët policorë – viktimat – Z A , V I dhe E D ,

gjersa e kanë përshkruar incidentin në detaje, - edhe pse asnjëri prej tyre nuk e ka njohur asnjërin nga kryesit e veprës – janë konsideruar si të mjaftueshme për t'i konsideruar ato si të vërtetuara plotësisht. Në lidhje me specifikat e plagëve që ata zyrtarë policorë i kanë pësuar, raportet mjekësore të padiskutueshme dhe të gjera të secilës prej viktimave kanë lejuar që të konkludohet vërtetësia absolute e tyre, për më tepër, kanë qenë të konfirmuara vazhdimisht nga secila deklaratë e dhënë nga viktimat si dëshmitarë në këtë gjykim. Gëzhojat/kapsulat e gjetura në vendin e krimit ashtu sië janë dhënë dhe analizuar përmes ekspertizës në vitin 2004, gjersa janë krahasuar me ato të gjetura në vendin e krimit të datës 24 dhjetor 2004 ka lejuar që definitivisht të identifikohen ata dhe që të bëhet lidhja e tyre me pistoletën " T " që është përdorur nga i pandehuri në datën e fundit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Sidoqoftë, nuk ka pasur prova tjera për ta lidhur pistoletën "T " si ajo e cila është përdorur me datë 15 shtator 2004 me të pandehurin, përpos faktit se i pandehuri e ka pasur në posedim dhe e ka përdorur të njëjtën armë, në të njëjtin " *modus operandi*", 3 muaj e 9 ditë më vonë në Tetovë. Asnjë provë ADN-je/e gjakut, nuk është gjetur në mënyrë që ta lidhë në ndonjë mënyrë të pandehurin me vendin e krimit të datës 15 shtator 2004 dhe pabarazia e thjeshtë e versioneve në lidhje me nxjerrjen e armës në fjalë- qoftë ajo e dhënë nga A K tek Xh Sh dhe më tej t'i jetë dhënë të pandehurit, ose duke qenë e vjedhur më parë nga Xh Sh tek Grupi i A K , nuk bën ndonjë ndryshim të rëndësishëm, përpos, as që mund të konfirmohet nga Xh Sh , siç thuhet i vdekur në datën aktuale.

Fakti është se, pa asnjë njohje që lidhet me datën 15 shtator të vitit 2004 dhe asnjë dëshmi tjetër teknike të mbledhur, ekzistimi i dyshimit të bazuar se L J e ka përdorur po të njëjtën armë për më shumë se 3 muaj më parë, nuk përputhet me kërkesat e përtej çdo të arsyeshëm ashtu siç kërkohet ligjërisht për një dënim të mëtejshëm se po ashtu e ka përdorur atë me datë 15 shtator 2004. Në të vërtetë, paneli deklaroi se situata e dytë nuk është ndarë nga e para vetëm disa orë ose ditë, por më shumë se 3 muaj që nuk mund të çojnë në një përfundim tjetër nga ajo e mungesës së provave të mjaftueshme për ta lidhur përfundimisht të akuzuarin me gjendjen në Sh.

B) Situata në T- 24 shtator 2004: pikat 6, 8 dhe 9 të aktakuzës

Bazat faktike:

c. Faktet relevante si në vijim në lidhje me **PIKAT 6, 8 dhe 9**, janë konsideruar si të **PROVUARA**:

1. Me 24 dhjetor 2004, rreth orës 20:00 dhe 20:30, së paku 17 zyrtarë policorë ishin në detyrë për të shkuar, tek një apartament i njohur si XXX, Tetovo , Maqedoni . Ata kanë qenë të udhëzuar se i pandehuri besohej që të ishte i pranishëm në njërën nga banesat që e përbënin ndërtesën. Për arsye se besohej që ai të ishte jashtëzakonisht i dhunshëm, i armatosur dhe i rrezikshëm, me urdhër-arreste ndërkombëtare të shumta të lëshuara kundër tij, detyra e arrestimit të tij i qe caktuar njësisë speciale të policisë. Para se të arrinin në vend ngjarje, ata janë informuar në tërësi dhe atyre u është treguar një fotografi e fytyrës së të pandehurit në mënyrë që ata të mund ta njihnin më lehtë.
2. I pandehuri në fakt i nënshtrohej një letërreshtimi që ishte lëshuar nga Kombet e Bashkuara me datë 19 shtator 2003 dhe që tregonte se ai i nënshtrohej një numri të fletë-arresteve për akuza të ndryshme të rënda duke përfshirë edhe Përgatitjen për ta Kryer një akt të Terrorizmit, Kidnapim, Mbajtje të paligjshme, Detyrim dhe Lëndim i rëndë trupor, me ç'rast vendet që i kishin lëshuar të gjitha këta urdhra ishin S dhe M Z.
3. Së paku 17 zyrtarë policorë kanë marrë pjesë tek ndërtesa dhe një numër prej tyre ka mbetur jashtë pronës në mënyrë që të ruanin arratisjen e të pandehurit.
4. Së paku 8 zyrtarë policorë janë ngjitur në katin e dytë duke i përdorur shkallët ku ata janë rreshtuar lart në korridor jashtë banesës nr. xxx
5. Banesa përbëhej nga një korridor para banesës, një dhome të ndejës, një banjo dhe tre dhoma të fjetjes.
6. Zyrtari i parë mbante një mburojë balistike në të ashtuquajturin "formatin e gjarprit". Edhe pse ata kanë qenë në rroba të thjeshta civile, ata mbanin xhaketa anti-plumb që e kishin fjalën 'policia' të shtypur në pjesën e përparme.
7. Linja e zyrtarëve ishin të përgatitur për ta hapur derën me forcë. Sidoqoftë, kur njëri prej tyre e ka provuar dorezën e derës, është zbuluar se dera ka qenë e pambyllur me çelës dhe prandaj ata e kanë hapur atë.



8. *Posa ata e kanë hapur derën e pambyllur me çelës dhe i kanë thënë paralajmërimet me zë të lartë se ata ishin policia dhe se banorët duhet të ndalonin dhe t'i çonin duart e tyre lart, L J , pa asnjë arsyetim ligjor apo mbrojtje ligjore, ka gjuajtur në drejtim të së paku dy zyrtarëve policorë, duke e përdorur pistoletën e tipit "T " me kalibër 7.62 x 25mm, me numër serik P... dhe në momentin e njëjtë dritat janë fikur dhe ai është fshehur në dhomën e fundit të fjetjes së banesës, prej ku ai më vonë ka gjuajtur edhe 5 herë në po të njëjtin drejtim si më parë. Asnjë nga të shtënat e gjuajtura në drejtim të policisë nuk ka shkaktuar vdekjen e ndonjërit prej tyre.*
9. *Në po të njëjtin rast me L J , po ashtu ka qenë prezent brenda banesës edhe V A , F S dhe L D , të gjithë të ulur rreth një tavoline në dhomën e ndejës.*
10. *Pothuajse menjëherë, Xh Sh , që ka qenë brenda në dhomën e mesme të po së njëjtës banesë, ka gjuajtur një numër të papërcaktuar të shtënash duke e përdorur një pushkë automatike 7.62 x 39mm.*
11. *Menjëherë një numër i paidentifikuar i zyrtarëve që po hynin në dhomën e ndejës në atë moment, janë tërhequr në korridor dhe janë kthyer sërish brenda duke ia kthyer me zjarr në drejtimin e dy dhomave (të mesme dhe dhoma e fundit) prej nga dritat e të shtënave të armëve të zjarrit ishin të dukshme, përkundër errësirës së dhomës së ndejës.*
12. *Përgjatë shkëmbimit të zjarrit një nga zyrtarët, dëshmitari "E" që qëlluar dhe ka pësuar lëndime të rënda nga gjuajtjet e zjarrit prej burimeve të paidentifikuara, edhe pse kanë ardhur nga një apo dy dhomat e përmendura më parë.*
13. *Menjëherë pasi që dëshmitari "E" ka bërë titur se ai që plagosur, njësia e Policisë, gjersa gjuante siç që përshkruar, e tërhequr në pjesën e jashtme të banesës, duke e shpëtuar zyrtarin policor të plagosur, që është dërguar në spital për trajtim, dhe të gjitha elementet tjera kanë mbetur jashtë njësisë duke u rifutur në banesë më vonë, kur kanë pushuar të shtënat.*
14. *Dëshmitari 'E' është dërguar në spital ku është konstatuar se ishte plagosur me armë zjarri në gjoksin e tij dhe në ije. Ai ka marrë tre muaj pushim mjekësor për periudhën e rikuperimit përgjatë së cilës ai i është nënshtruar një numri të operacioneve, ekzaminimeve dhe intervenimeve.*
15. *Gjatë shkëmbimit të zjarrit siç është përshkruar më sipër, së paku janë gjuajtur 6 të shtëna nga një pistoletë e tipit T 7.62x25mm P...; 25 të shtëna nga një pushkë*

- automatike C Z M92 7.62x39mm dhe 11 të shtëna nga një pushke automatike e paidentifikuar 7.62x39mm dhe 6 granata qenë gjuajtur pa shpërthyer.
- 16.L D ka vdekur në vend për shkak të një të shtëne nga një burim i paidentifikuar që ka rezultuar nga shkëmbimi i të shtënave siç është përshkruar më lartë.
- 17.V A dhe F S i janë dorëzuar policisë pasi që kanë pushuar të shtënat.
- 18.L J është larguar nga vendi, duke ikur përmes ballkonit apo një dritareje të dhomës në rrethana të papërcaktuara dhe është trajtuar dhe dërguar në spitalin e Prishtinës në Kosovë të nesërmen rreth orës 3:30 min me plagët e marra nga një armë zjarri edhe në gjoks edhe në rajonin e djathtë të gjymtyrës.
- 19.Xh Sh është larguar nga vendi duke ikur nën rrethana të njëjta të papërcaktuara në një vend të panjohur.
- 20.Pushka automatike 7.62x39mm C Z është gjetur e braktisur në pjesën me bari të "E -it" në afërsi të banesës së sipërpërmendur në rrethana të panjohura, së bashku me disa gjurmë të gjakut në dëborë.
21. Duke pasur për qëllim që të mos zihej dhe për të ikur, edhe pse ka gjuajtur në drejtim të dy zyrtarëve policorë, L J ka tentuar që t'i privojë ata nga jeta, kështu që ai ka qenë në dijeni se vdekja mund të shfaqet si një pasojë e ndaluar e veprimeve të tija ai ende ka vazhduar me veprimin e tij.
22. Ai ka vepruar në një kohë kur zyrtarët policorë po i ekzekutonin detyrat e tyre të mbrojtjes së rendit të ligjit, duke i zbuluar aktivitetet kriminale, dhe burgosur kryesin e veprës penale dhe duke mbajtur rendin publik dhe qetësinë.
23. Xh Sh së bashku me L J kanë sjellë në vendin e sipërpërmendur, së paku një duzinë e armëve të paidentifikuara, e cila së paku përfshinte një pistoletë të tipit "T" kalibër 7.62 x 25mm, me numër serik P... , me 1 fishek të gjetur në magazinë, 256 fishekë të plotë të vendosur në 15 pako, 8 karikatorë për pushkë automatike që përmbanin një total prej 180 fishekëve, 54 fishekëve të tipit V të kalibrit .308, një granatahedhës MGL-6 numri serik i hequr, një pushke automatike C Z M92, me kalibër 7.62 x 39m, me numër serik ..., dhe një pushkë automatike të paidentifikuar të kalibrit 7.62 x 39mm dhe 6 granata, të cilave i është shtuar sasia e municionit të gjuajtur e provuar më sipër.
24. Në kohën që ai e ka përdorur pistoletën "T" dhe i ka poseduar armët e tjera në bashkë-kryerje me Xh Sh , L J ka vepruar në atë mënyrë pa pasur një autorizim valid të armëve për to.

25. L J është dënuar me 14 shkurt 2007 përmes një aktgjykimi të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Gjiilan për dy pika të akuzës në lidhje me kidnapim, 4 pika të akuzës për mbajtje të paligjshme të armëve dhe 3 pika të akuzës për detyrim për veprime të kryera në shtator të vitit 2000. Ai qe dënuar me një dënim të rëndë prej 6 vitesh burgim.

Faktet në vijim , në lidhje me **PIKAT 6, 8 dhe 9**, janë konsideruar si të PA PROVUARA:

26. Se L J së bashku ka marrë pjesë me Xh Sh në të shtënat me armë ashtu siç është dhënë më sipër;
27. Se L J ka gjuajtur në drejtim të më shumë se dy zyrtarëve policor para se dritat të fikeshin dhe para se të strehohej në brendësi të dhomës së fundit të banesës.
28. Se të shtënat e tjera që L J i ka gjuajtur me pistoletën T nga brendësia e dhomës së fundit të banesës kanë qenë të drejtuara në drejtim të më shumë se dy zyrtarëve policorë dhe se ai e ka ditur se ka pasur më shumë polic brenda në dhomën e ndejës në momentin që janë gjuajtur këto të shtëna;
29. Se L J ka gjuajtur ndonjë të shtënë nga pushka automatike C Z M92, me kalibër 7.62 x 39m, numër serik ...ose nga ndonjë pushkë tjetër e paidentifikuar e kalibrit 7.62 x 39mm brenda ndonjëres nga dhomat e banesës;
30. Se Xh Sh ka qenë vetëm në dhomën në mes dhe se Xh Sh nuk ka qenë po ashtu edhe në dhomën e fundit në një moment tjetër, të njëjtë apo nuk ka qenë me L J ;
31. Se L J të ketë gjuajtur me granatahedhesin MGL-6 me numër serik të fshirë të gjetur në vendin e krimit, ose në mesin e dhomës apo në fund të dhomës;
32. Se dëshmitari E ka qenë në shënjestër dhe qëlluar nga L J;
33. Se qëllimi i L J ka qenë që të vrasë sa më shumë zyrtarë policorë që të jetë e mundur.
34. Se L J ka menduar se zyrtarët policorë nuk ishin policia por një grup rival në vend të tyre.

#### Arsyetimi dhe gjetjet:

Si një shënim fillestar për analizimin e provave, ashtu si janë mbledhur dhe paraqitur para shqyrtimit gjyqësor, duhet të epen disa konsiderata të mëparshme. Faktet në

fjalë datojnë prapa në vitin 2004 dhe njëmbëdhjetë vitet e kaluara medoemos kanë prodhuar një ndikim negativ në fuqinë dhe efektet e provave të mbledhura. Shumica e provave të dokumentuara/teknike nuk mund të përsëriten edhe nëse do duhej dhe efekti i ndikimit kohor jo vetëm saktësia e përshkrimit faktik e marrë nga dëshmitarët por ekzistenca e duhur e dëshmitarëve, disa prej tyre të ndjerë tani dhe prandaj, në lidhje me këtë, deklaratat nuk mund të merren apo të ri-merren. Në anën tjetër, edhe pse numri i dëshmitarëve të deklaruar mbi të njëjtat fakte nuk mund të konsiderohet si i ulët, natyra e shpejtë e disa prej fakteve relevante natyrshëm ka shpënë në përshkrimet e pakapshme dhe të pjesshme të të njëjtës gjë, duke marrë parasysh kohën tashmë të kaluar, si edhe elemente të tjera faktike që shoqërojnë kohën e tyre të shpejtë: errësira e vendit, natyra profesionale e punës së kryer nga dëshmitarët si zyrtarë policorë deri në datën e sotme, si dhe ekzistenca e një plani të mëparshëm standard operativ për situata standarde si të tilla. Këta faktorë të rëndësishëm do të shpjegohen më poshtë pasi ato kanë inkorporuar me vendosmëri tërë vlerësimin e panelit gjersa kanë vlerësuar dhe analizuar në mënyrë kritike provat e prodhuara. Përputhja e provave të prodhuara nuk mund të analizohet vetëm në bazë të një shume të thjeshtë të detajeve në kuadër të deklaratave, por edhe nga përputhshmëria e saj brenda dhe jashtë, gjithmonë e filtruar nga mendja e shëndoshë, si dhe nga fakte të tjera paralele dhe me sa duket të parëndësishme të provuara. Llogaritja e fakteve siç janë dhënë më sipër do të respektohet në arsyetimin e panelit si në vijim;

**Faktet 1, 2, 3, 4, 7 dhe 22:** Gjykatës i janë dhënë 13 deklaratat të zyrtarëve policorë si dëshmitarë anonim që kanë marrë pjesë drejtpërdrejtë në operacion dhe të gjithë ata vazhdimisht e kanë përshkruar planin, vendin, kohën, cakun, metodat, numrin e policëve të përfshirë, detyrat përkatëse të ndara siç ishte sigurimi i perimetrit të ndërtesës, si dhe ata të ngarkuar për të hyrë brenda në banesë dhe fakti që dera ka qenë e pambyllur po aq vendimtar për atë se si plani operacional është zhvilluar më tej. Të gjithë kanë sqaruar vazhdimisht detyrën përkatëse edhe pse jo saktësisht urdhri në fjalë në formacionin *gjarpër* e cila është konsideruar si natyrale, duke pasur parasysh natyrën përsëritëse të punës së tyre profesionale dhe kohën që ka kaluar. Arsyeja për operacionin është e bazuar mirë mbi prova të dhëna nga kërkimet nominale të Interpolit, letërreshtimit të datës 19 shtator 2003- Lidhësja III, faqe 1-9.

Edhe pse të gjithë ata dëshmitarë kanë qenë nën statusin anonim, konfirmimi i mëtejshëm i fakteve në vijim nga dëshmitarët V A dhe F S si dhe provat e dokumentuara të prodhuara si rezultat i operacioneve nuk mund të lejonin që të konkludohet ndryshe. Prandaj, këto deklarata dëshmitarësh edhe pse nga burime anonime, nuk janë vetëm që t'i provojnë të gjitha këto fakte.

**Fakti 5:** Lidhur me këtë fakt ka qenë e mjaftueshme prova e dokumentuar e paraqitur para trupit gjykues përmes analizës së rrugës, ndërtesës dhe planit të banesës –Lidhja III, faqe 1-9, absolutisht në përputhje me të gjitha fotot dhe skicat të marra më vonë në vendin e krimit, që nuk janë kundërshtuar nga asnjë copëz tjetër e dëshmisë çoftë nga ndonjë deklaratë e ndonjë dëshmitari ose nga ndonjë provë tjetër e dokumentuar, si të dhënat mbi përshkrimin e vendit të krimit-Lidhja III, faqe 10-21, të dhënat mbi gjetjen e gjurmëve dhe gjësendeve nga kërkimet e bëra në vendin e krimit si dhe foto albumi i vendit të krimit- Lidhja III, faqet 22-209 si dhe foto albumi –Lidhja IV, faqet 1-11.

**Fakti 6:** Dëshmitari J, e konfirmoi te këtë qenë vetë komandant i operacionit të futjes brenda dhe ka theksuar detajet e formacionit gjarpër të udhëhequr nga një zyrtar tjetër që mbante një mburojë. Ai po ashtu ka përshkruar karakteristikat e mburojës në madhësi dhe ngjyrë si dhe detajin e fjalës POLICIA të vendosur në pjesën e përparme. Së fundi, ai ka qenë bindës kur ka theksuar në mënyrë të çartë se të gjithë zyrtarët kanë pasur të veshur rroba të thjeshta civile mbi të cilat të gjithë kanë pasur të veshur jelekë anti-plumb me fjalën POLICIA edhe në pjesën e përparme edhe të prapme. Kjo deklaratë është konfirmuar vetëm pjesërisht nga dëshmitarët A, C, E, G – ai i cili e mbante mburojën – R, I dhe Q, për më tepër asnjëherë të kundërshtuar nga dikush tjetër. Dëshmitari V A ka theksuar se të dy zyrtarët policorë që ai i ka parë kur dera qe hapur kanë qenë të veshur në uniforma police. Kontradikta formale e kësaj deklarate të fundit duhet që të analizohet nën parametrat e sqaruara fillimisht duke përfshirë kohën që ka kaluar që nga viti 2004, situata e stresuar dhe koha e shkurtë, duke pasur parasysh imazhin që V A e ka pasur kur ai vetëm ka shikuar në derë. Trupi gjykues është mjaft i bindur se në vend se thjesht të gënjejë, ai e ka pasur atë bindje të uniformave të marrë nga jelekë të ngjashëm me fjalën POLICIA në to në pjesën e përparme si dhe në mburoja.

Prandaj, trupi gjykues është i bindur se deklarata e tij e ka konfirmuar në fakt tërë vërtetësinë e deklaratave të të gjithë dëshmitarëve të sipërpërmendur anonim.

**Faktet 8, 10, 11, 29, 30 dhe 31:** Këto fakte qenë konsideruar të gjitha së bashku si vendimtare për vlerësimin final të trupit gjykues mbi provat e prodhuara. Në të vërtetë, trupi gjykues ka vërejtur se si deklaratat e ndryshme të dëshmitarëve kanë reflektuar në vështirësitë duke definuar një pasqyrë më të qartë të incidentit që, në fund të fundit, nuk është bërë e mundur përtej një niveli të caktuar. Arsyet janë të natyrës heterogjene, meqë dinamika e saj në veçanti, koha që ka kaluar, perceptimi i ndryshëm i realitetit nga dëshmitarë të ndryshëm veç e kanë formatizuar një plan të parapërcaktuar dhe me procedurat standarde në këso aksione të mësymjes por nën një situatë të stresuar të të qenit nën zjarr. Duke pasur parasysh të gjitha deklaratat e dhëna, paneli i ka analizuar ato së bashku dhe ka arritur në versionin faktik që është konsideruar si të qenit e vetmja kompatible me provat e paraqitura si tërësi. Është me rëndësi që të vihet në dukje se provat nuk do jenë më të forta duke qenë vetëm një sasi e deklaratave të njëjta, kështu duke i shndërruar ato medoemos më shumë të besueshme se ato tjerat që janë paraqitur në një numër më të vogël. Një pamje kritike mbi provat e prodhuara, të filtruara nga një logjikë e domosdoshme, mundet disi dhe dikur, që t'i përmbys këto konkludime kryesore kuantitative.

Lidhur me faktin e kontestuar nëse dera kryesore ishte e hapur apo jo, trupi gjykues kishte dëshmitarët R, J dhe Q duke e pohuar faktin në një rën anë, dhe V A , F S dhe L J duke e mohuar atë nga ana tjetër. Sidoqftë, trupi gjykues është informuar nga dëshmitarët R, J dhe Q duke theksuar se këto procedura specifike të mësymjes ekzistojnë si për dyert e mbyllura ashtu edhe për ato të hapura dhe dëshmitarët R dhe Q do ia mësynin derës vetëm nëse do kishte nevojë sepse kjo ka qenë puna e tyre e veçantë së bashku me formacionin e gjarprit, si dhe duke qenë dëshmitari J në krye si komandant i këtij operacioni. Të gjithë nga ata kanë theksuar në mënyrë specifike se ata nuk ia kanë mësy derës në këtë situatë të veçantë. Për më tepër, ai lokacion final i trupit të vdekur të L D , pothuajse 4 metra larg nga dera, ashtu siç është theksuar nga dëshmitarët a dhe J, definitivisht diskrediton deklaratat e V A , F S dhe L J në lidhje me faktet specifike.

Në lidhje me paralajmërimin "Policia, stop! Duart lart"! që është thënë me zë të lartë, trupi gjykues nuk ka dyshime duke pasur parasysh se që të gjithë të 13 zyrtarët policorë si dëshmitarë anonim, si dhe V A dhe F S e kanë konfirmuar në mënyrë të çartë. Për më tepër, procedurat standarde të një njësie zyrtare policore e trajnuar për këso qëllime specifike nuk mund të lejojë që të konkludohet ndryshe.

Duke qenë L J personi që ka qenë i ulur së bashku rreth tavolinës me L D , V A dhe F S në dhomën e ndejës së banesës së identifikuar, si dhe duke qenë ai personi që e ka rrëmbyer pistoletën dhe ka gjuajtur kundër elementeve të njësisë policore, të dukshme në atë kohë, ka qenë e konfirmuar nga dëshmitari E i cili e ka njohur L J nga fotoja e tij e mëparshme e prezantuar përgjatë brifingut nga V A , i cili ka konfirmuar se L J e ka pasur një pistoletë në tavolinë dhe nga L J i cili kurrë nuk i ka mohuar këto fakte, duke pasur parasysh trupi gjykues edhe konfirmimin e ADN-së dhe identifikimin e gjurmëve të gjakut të lëna prapa brenda banesës dhe ato që janë marrë në spitalin e Prishtinës duke e identifikuar L J si të pranishëm në T në natën kritike, sipas Ekspertizës 1207/2004 të gjurmëve të armëve të zjarrit dhe gjurmëve të gjakut- Lidhësja III, faqet 276-283, Raporti në lidhje me marrjen e mostrës së ADN-së të L J -Lidhësja V, faqet 128-137' dhe ekspertiza 1178/04 e arëve të zjarrit, gjurmët e armëve të zjarrit dhe gjurmët e origjinës biologjike-Lidhësja III, faqe 220-246.

Në lidhje me dinamikën e të shtënave (fakti 11), dyshime të mëdha janë ngritur dhe deklaratat e 10 dëshmitarëve anonim nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përcaktuar se sa zyrtarë policorë kanë qenë të dukshëm në momentin e saktë kur L J ka gjuajtur duke e përdorur pistoletën para se të strehohej brenda dhomës së fundit dhe para se të fikeshin dritat. Sipas V A t, kanë qenë vetëm dy, njëri prej tyre prapa mburojës gjersa e ka varur. Dëshmitarët R dhe J po ashtu i kanë përmendur dy prej tyre, sidoqoftë, të gjithë të tjerët nuk kanë qenë të çartë duke pohuar se më shumë se dy veta kanë qenë brenda para se të fikeshin dritat. Vetëm dëshmitari E është mjaft i sigurt se ai ka qenë mjaft i sigurt se ai ka qenë brenda dhomës së ndejës, duke përshkruar në mënyrë të çartë reagimin e të pandehurit në një mënyrë të detajuar. Dëshmitarët anonim të marrë në pyetje para trupit gjykues kryesisht kanë konfirmuar që të jenë futur në dhomën e ndejës por vetëm në një moment më të vonshëm, kur ata ua kanë kthyer të shtënat me armë zjarri, posaçërisht kundër të

shtënave me armë zjarri që vinin nga 2 dhomat e fjetjes, ajo e mesme dhe ajo e fundit. Zyrtarët policorë në mënyrë shumë të çartë konfirmonin se si një veprim i menjëhershëm, L J ka gjuajtur me pistoletë dhe është fshehur brenda dhomës së fundit gjersa dritat janë fikur. Në një situatë të zakonshme, si dhe sipas planit fillestar operacional, i gjithë gjarpri do futej brenda në dhomën e ndejës dhe do e dorëzonte L J duke mos pasur ndonjë reagim nga i fundit. Sidoqoftë, përgjigja e tij e papritur ka shkaktuar një tërheqje të njësisë së policisë jashtë banesës, ashtu siç është deklaruar nga dëshmitarët A, B dhe C, ku një pjesë e operacionit gjarpër qe ende e vendosur dhe, disa çaste me vonë, një ri-hyrje e menjëhershme gjersa kanë shkëmbyer një zjarr intensiv. Një version tjetër nuk do ishte i qëndrueshëm në një kohë të shkurtë siç është përshkruar dhe një reagim i menjëhershëm nga L J i. Në veçanti, nuk do ishte e mundur të ishin 8 apo 10 zyrtarë policorë brenda dhomës para se L J të fillonte të gjuante dhe të futej në dhomën e fundit të fjetjes. Po të kishin qenë të shtënat që ktheheshin të shoqëruara me lëvizjen e tërheqjes fillestare të L J , ai nuk do kishte pasur kohë dhe hapësirë të mjaftueshme që të strehohej brenda dhomës së fjetjes. Duke pasur parasysh që të dyja deklaratat e dëshmitarit E dhe V A , trupi gjykues ka konkluduar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për ta mbështetur nivelin e " përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" se më shumë se dy zyrtarë policorë kanë qenë në dukje kur L J ka gjuajtur nga pistoletë që e ka rrëmbyer, para se të futej në dhomën e fundit të fjetjes dhe dritat janë fikur.

Fakti i dytë i dyshueshëm është ngritur nga e shtëna e gjuajtur nga mesi i dhomës së fjetjes, supozohet nga Xh Sh , i cili sipas V A , F S dhe L J (ashtu siç janë referuar në mënyrë specifike në aktakuzë) ka qenë i pranishëm në banesë që nga një ditë më parë, ka arritur së bashku me L J . Trupi gjykues e ka vlerësuar si të vërtetë këtë fakt duke pasur parasysh deklaratat e dëshmitarëve A, B dhe C dhe J të lidhura me rastet e plumbave të mbledhura nga vendi i krimit të cilat tregojnë në mënyrë të çartë një të shtënë zjarri nga një pushkë automatike dhe një RPG nga mesi i dhomës së fjetjes dhe një pushkë automatike, një pistoletë dhe RPG-ja e njëjtë që vinin nga dhoma e fundit e fjetjes. Zjarri shoqërues që ka ardhur nga të dyja dhomat e fjetjes ashtu siç është deklaruar nga dëshmitarët B dhe C, lejojnë që të konkludohet se dy individë të ndryshëm kanë gjuajtur; për më tepër duke pasur parasysh vendet specifike prej të cilave gëzhojat RPG janë mbledhur nga vendi i krimit, tregon në mënyrë të çartë se po e njëjta RPG është shkaktuar nga që të dyja dhomat e fjetjes,



ajo e mesme dhe e fundit. Fakti specifik medoemos tregon se RPG ja është larguar nga njëra dhomë në tjetrën dhe prandaj bën ngritjen edhe të një dyshimi përkatës; kush ka gjuajtur RPG-në në secilën nga dhomat? Dhe nëse ka qenë apo jo Xh Sh po ashtu brenda dhomës së fundit të fjetjes dhe nëse ka gjuajtur nga atje dhe se në cilin moment ka mundur që të ndodhë kjo? Kjo medoemos të shpije edhe në dyshimin se kush ka gjuajtur nga pushka automatike C Z nga dhoma e fundit duke lënë pas gëzhojat përkatëse të plumbave që janë mbledhur më vonë në vendin e krimit. Duke pasur parasysh se dyert e që të dyja dhomave të fjetjes janë të puthitura ashtu siç mund të shihet edhe nga plani i banesës, dhe se asnjëri nga dëshmitarët nuk ka përmendur ndonjë lëvizje të njerëzve në mes të dhomave, duke qenë dritat e fikura, nuk është e mundur që definitivisht të konkludohet e kundërta. Prandaj, vetëm të shtënat e gjuajtura nga pistoletat T në përputhje me 6 gëzhojat që janë mbledhur më vonë me siguri mund t'i atribuohen L J i cili më parë e mbante atë pistoletë para se të futej në dhomën e fundit. Për më tepër, deklarata e mëparshme e L J që ka pranuar që ka të ngjarë që të ketë gjuajtur nga pushka automatike C Z është më ndryshe nga pranimi se e ka bërë këtë gjë; për më tepër, është një deklaratë e izoluar që nuk është e pranueshme si një provë e vetme kundër tij ( neni 123, paragrafi 5 i KPPK-së).

Kjo po ashtu e ka bërë të paqartë rrethanën konkrete në të cilën Xh Sh dhe L J kanë dalur nga banesa, në cilin moment, ku, në veçanti, nëse apo jo L J ka qenë individ që dëshmitari J i është referuar në deklaratën e tij kur kanë gjuajtur dhe kanë kërcyer nga ballkoni, apo ka qenë më shumë Xh Sh . Asnjë nga dëshmitarët nuk kanë mundur që ta njohin L J gjersa ka ikur dhe aq më pak Xh Sh , apo të përshkruaj në më shumë detaje këtë fakt specifik. Prandaj, nuk ka prova fare se kush e ka lënë pushkën automatike C Z jashtë banesës.

**Faktet 12, 13 dhe 14:** Të gjithë dëshmitarët kanë deklaruar në mënyrë konsistente në lidhje me rrethanat ku dëshmitari E është plagosur nga zjarri që vinte nga njëra prej dhomave të gjumit dhe rrethanave që pasuan në lidhje me evakuimin e tij në spital, duke qenë dëshmitari E mjaft i qartë në lidhje me këtë si viktimë e drejtpërdrejtë, dhe e konfirmuar nga deklaratat e dëshmitarëve L dhe R të cilat drejtpërdrejt e kanë ndihmuar atë, si dhe shënimet mjekësore në Lidhësen II, faqet 55-66.

**Fakti 15:** Lidhur me këtë fakt paneli mbështetet në prova teknike që kanë rezultuar nga koleksioni i objekteve të marra në vendin e ngjarjes dhe ekspertizën e mëtejshme të kryer mbi to, domethënë, Raporti për analizën e fletë pluhurit dhe e përcaktimit të llojit të gjakut - Lidhja III, faqet. 266-268; Ekspertiza 1207/2004 e gjurmëve të armëve të zjarrit - Lidhja III, faqet. 276-283; Raporti mbi ekzaminimin e armëve të zjarrit – Lidhja III, faqet. 210-215; Analiza e armëve të zjarrit dhe provat e shkarkimit të armëve të zjarrit – Lidhja III, faqet. 216-219; Ekspertiza 1178/04 e armëve të zjarrit, gjurmët e armëve të zjarrit dhe gjurmët e origjinës biologjike – Lidhja III, faqet. 220-246; Raporti mbi ekzaminimin e gjurmëve të armëve të zjarrit – Lidhja III, faqe. 247-252; Raporti mjeko-ligjor mbi analizën e armëve të zjarrit - Lidhja III, faqet. 253-261; Verifikimi mbi gjësendet e konfiskuara përkohësisht - Lidhja III, faqet. 269-274; Shënim gjyqësor zyrtar 1126/2014 në lidhje me shkuarjen në vendin e krimit - Lidhja III, faqet. 262-265; dhe ekspertiza 1207/2004 e gjurmëve të armëve të zjarrit dhe gjurmët e gjakut - Lidhja III, faqet. 276-283.

**Faktet 9, 16 dhe 17:** Këto fakte janë konfirmuar mjaft nga personat e përmendur V A dhe F S dhe i pandehuri L J, në përputhje me shënimin zyrtar 1126/2014 në lidhje me shkuarjen në vendin e krimit në Lidhjen III, faqet. 262-265, dhe në lidhje me praninë dhe vdekjen e L D, Raporti i Autopsisë së tij Lidhja III, faqet. 284-304 dhe foto albumi në Lidhjen IV, faqet. 1-11 të cilat së bashku në mënyrë të mjaftueshme e konfirmojnë deklaratën e dëshmitarit E dhe të të gjithë atyre që kanë konfirmuar dorëzimin më vonë të të mbijetuarve.

**Faktet 18 dhe 19:** duke pasur parasysh faktin se asnjë deklaratë nuk është e çartë në lidhje me atë se SI dhe KUR L J u largua nga banesa si dhe Xh Sh , i vetmi përshkrim pozitiv që dhënë nga dëshmitari J duke iu referuar një individ të paidentifikuar që largohej nga dhoma e fundit e fjetjes, duke gjuajtur një pushkë automatike dhe duke ikur nga ballkoni, gjersa dhoma e ndejës ka qenë në errësirë. Nën pretendimin e fortë, se ka mundësi që të dy të kenë qenë brenda dhomës së fundit të fjetjes, së bashku, ose njëri pas tjetrit, duke pasur parasysh gëzhojat e RPG-së të gjetura në që të dyja dhomat e fjetjes, asnjë konkludim tjetër i saktësisë nuk mund të nxirret nga deklarata e përmendur. Ia vlen që të përmendet se edhe pse e përshkruar në aktakuzë, asnjë provë nuk është paraqitur në lidhje me Xh Sh , i raportuar si i vdekur në këtë datë të tanishme. Në lidhje me shkuarjen e L J në spitalin e Prishtinës ashtu

siç është dhënë në detaje, trupi gjykues e ka konsideruar si relevante Raportin në lidhje me marrjen e mostrës së ADN-së së L J t- Lidhja V, faqet. 128-137; Dorëzimi dhe përmbledhja e dosjes mjekësore të L J - Lidhja IV, faqet. 12-15; Përmbajtja e dosjes mjekësore të L J 't- Lidhja IV, faqet. 16-101 dhe Flete lëshimi nga spitali me Epikrizë - Lidhja IV, faqet. 102-109.

**Fakti 20:** Së bashku me deklaratën jo bindëse të dëshmitarit B, trupi gjykues është mbështetur në përshkrimin e vendit të ngjarjes që vërteton gjetjen e pushkës automatike C Z jashtë banesës në dëborë, si dhe përmes fotografive të marra, Lidhja III, fq. 77-78

**Faktet 21, 27, 28 dhe 33:** I gjithë përshkrimi i fakteve siç është bërë nga të gjithë dëshmitarët anonimë, së bashku me deklaratën e dhënë nga L J gjatë shqyrtimit kryesor, e ka lejuar trupin gjykues për të vlerësuar, sa i përket çështjes së *mens rea*, në mënyrë të veçantë, se të shtënat nga L J synonin në thelb për të lejuar largimin e tij, por jo për ta parandaluar synimin për të vrarë si efekti më i mundshëm që rezulton nga të shtënat në drejtim të dy policëve për të paktën 6 herë. Kjo nuk ishte e mjaftueshme për të përfunduar megjithatë se ai kishte për qëllim për të vrarë sa më shumë zyrtarë policorë që të ishte e mundur, si rezulton prej aktakuzës. Nuk kishte asnjë provë të prodhuar për të vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se, ndërsa të shtënat nga brendia e dhomës së gjumit të fundit, L J ishte i vetëdijshëm se më shumë se 2 policë ishin të dukshëm që do të përballëshin me të shtënat e tija më vonë, për më shumë se këta 2 për të cilët ai ishte në dijeni, para se të strehohej brenda dhomës së gjumit dhe fikjes së dritave.

**Fakti 23 dhe 24:** Këto fakte janë pranuar nga L J i cili ka përshkruar se si janë dërguar këto armë në banesë, një ditë më parë nga ai vetë dhe Xh Sh , mjaft është konfirmuar edhe nga studentët V A dhe F S para trupit gjykues, të cilat përputhen me fotot e bëra nga që të dy L J dhe Xh Sh me V A dhe F S , si pjesë e dosjes së rastit, fotoalbumet në Lidhjen IV, faqet. 1-11, së bashku me ekspertizën në lidhje me armët e mbledhura nga vendi i krimit ashtu siç është referuar më parë.

**Fakti 25:** Trupi gjykues e ka konsideruar si provë valide dosjen kriminale të L J që është marrë e cila e konfirmon datën e dënimit 14 shkurt 2007 ashtu si në Lidhjen X,

faqet. 74. Asnjë aktgjykim tjetër (nga gjykata në T në Lidhjen V, faqet. 1 deri 9 apo cilado tjetër ashtu siç është referuar në përmbledhjen e Interpolit, Lidhja III, faqet. 1 deri 9) të jenë konsideruar si relevante, pasi që kjo e fundit, ekskluzivisht për dënimet në *mungesë* (absentia) nuk njihen si të filla nga Ligji i Kosovës si dënime të mëhershme valide.

**Fakti 26:** Duke pasur parasysh deklaratat e të gjithë dëshmitarëve anonimë siç janë dhënë para trupit gjykues nuk ka asnjë provë të vetme që, përveç për faktin e zjarrit shoqërues nga dy dhomat e gjumit, të ndryshme - që nënkupton pjesëmarrjen në gjuajtjen e të dyve L J dhe Xh Sh - nuk ka asnjë dëshmi se megjithatë kjo ka rezultuar nga një vendim i përbashkët, në një veprim plotësues ose në bazë të një veprimi të mëparshëm të planifikuar të artikuluar në mes të dyve. Trupi gjykues ka vlerësuar veprimet e kryera nga L J , si rezultat i opsioneve të tija individuale të marra nga momenti kur ai i ka nisur të shtënat dhe kur u strehua në dhomën e gjumit të fundit. Çdo e shtënë shoqëruese nga Xh Sh nuk mund t'i atribuohet L J , as në veprime, as në planin ose rezultatin si një bashkë-kryerje, apo faktikisht, si një pjesëmarrje e përbashkët.

**Fakti 32:** Edhe pse dy prej dëshmitarëve anonimë, duke përfshirë dëshmitarin J theksoi se dëshmitari E u plagos nga zjarri që erdhi nga njëra prej dhomave, ekspertiza që vazhdoi në vitin 2004 nuk ishte në gjendje për të përcaktuar se nga cila armë plaga e kishte origjinën. Njëmbëdhjetë vite kaluan, një ekspertizë e re u konsiderua si vështirë e përsëritshme, si dhe në thelb e parëndësishme përballë elementeve të veprave penale në fjalë.

**Fakti 34:** Lidhur me gabimin e pretenduar nga L J , se ai ka menduar që nuk ishte policia që po ia mësynte apartamentit por grupi i A K në vend të saj, ajo është konsideruar si tërësisht e paarsyeshme dhe për këtë arsye si e pavërtetë, e paaftë për të ngritur ndonjë dyshim serioz dhe/ose të besueshme në trupin gjykues. Në të vërtetë, zyrtarët e policisë kanë respektuar siç duhet të gjitha procedurat dhe standardet për një operacion si të tillë; ata ishin duke përdorur xhaketa operative dhe mburoja me fjalën policia të shkruar në to; L J kërkohej nga Interpoli për shkak të një urdhër-arresti në pritje duke i dhënë atij një arsye për t'u arratisur nga policia; një vëzhgues normal përfaqësuar këtu nga që të dy, V A dhe F S , menjëherë e

kuptuan që grupi ishte i përbërë nga zyrtarë policorë, pa asnjë dyshim; dhe më në fund, në asnjë moment të të shtënave, L J nuk ka pasur për qëllim të ketë një bisedë të pritshme dhe sqaruese nga brenda dhomës së gjumit prej ku ai u arratis. Në vend të kësaj, ai thjesht u largua dhe iku në Kosovë.

### **Bazat Ligjore**

Për qëllime të rrepta analitike, dhe siç është bërë më parë, baza e mëposhtme ligjore do të ndahet në dy grupe të situatave përkatëse faktike: Situata në Sh (Pikat 1, 2 4 dhe 5) dhe situata në Tetovë (Pikat 6, 8 dhe 9).

#### **Gjendja në Sh: Akuzat 1, 2, 4 dhe 5**

Pasi që është sjellë në shqyrtim gjyqësor, i pandehuri L J është akuzuar nën pikën 1, Tentim vrasje e rëndë në bashkëkryerje (nenet 147, § 4, 5 dhe 10, 20 dhe 23 KPK 2003), pika 2, Lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje (nenet 154, § 1 dhe 2, dhe 23 KPK 2003); pika 4, Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në bashkëkryerje (nenet 317, § 1 dhe 3, dhe 23 KPK 2003); dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në bashkëkryerje (nenet 328, § 1 dhe 2, dhe 23 KPK 2003).

Të gjitha këto vepra penale si të filla, kërkohet të kenë dy elemente edhe objektive edhe subjektive për një aktgjykim në vijim për caktim të dënimit. Pa asnjërin prej tyre, aktgjykimi do të jete doemos shfajësues. Njëri prej këtyre elementeve është lidhja e domosdoshme në mes të elementeve objektive në tërësinë e tyre në njërin anë dhe të akuzuarin në anën tjetër (e ashtuquajtura lidhja subjektive). Me fjalë tjera, është e nevojshme që të dëshmohet se të gjitha faktet objektive të paraqitura si të provuara mund t'i atribuohen të akuzuarit në një mënyrë të caktuar ligjore.

Përkundër kualifikimit ligjor që mund t'i atribuohet gjuajtjes së tre policëve në Sh, siç është përshkruar në aktakuzë, në të njëjtat rrethana të vendit dhe kohës, se a është vepër penale në bashkëkryerje apo jo, se a është një tentativë apo vrasje në

shumicë me rezultate tipike, se këto kualifikime ligjore në akuza të veçanta duhet të mblidhen apo duhet të konsumohen në mes tyre, këto të gjitha shndërrohen në çështje ligjore të papërdorshme po qe se Prokuroria nuk mund të provoj lidhjen në mes të këtyre fakteve dhe të akuzuarve, përmes provave të besueshme dhe vendimtare.

Në rastin konkret, andaj, edhe për akuzat 1, 2, 4 dhe 5, trupi gjykues ka përfunduar se asnjëri prej fakteve të hollësishme siç janë përshkruar në aktakuzë nuk kanë mundur t'i atribuohen të akuzuarit apo cilido prej të identifikuarve si kryesit e tyre apo bashkë kryesit në nivelin e duhur përtej dyshimit të bazuar për arsyet e lartpërmendura. Prandaj, vendimi i lirimit nga akuzat në lidhje me këto 4 akuza të lartpërmendura është konkluzioni ligjor i nevojshëm, pa konsideratë të mëtejshme ligjore.

#### **Situata në Tetovë: Akuzat 6, 8 dhe 9**

Për çështje analitike dhe duke marrë parasysh faktet e gjetura siç janë dëshmuar dhe janë paraqitur në hollësi si më lartë, situata në T do të ketë nevojë për një qasje të veçante për secilën prej akuzave të përfshira. Prandaj, ato do të konsiderohen një nga një në një sekuencë të duhur si në vijim.

A) Akuza 6 – Tentim vrasje e rëndë në bashkëkryerje (nenet 147, § 4, 5 dhe 10, 20 dhe 23 KPK 2003)

Neni 147 i KPK (2003) lexon,

“Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili:

(...)

4) Privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave;

5) Privon nga jeta personin tjetër duke vepruar mizorisht e dhunshëm;

(...)

10) Privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në mbrojtje të rendit ligjor, sigurimit të njerëzve apo të pasurisë, zbulimit të veprave penale, arrestimit të kryerësit të veprës penale, ruajtjes së personave të privuar nga liria ose ruajtjes së rendit dhe të paqes publike;

11) Me dashje kryen dy apo më shumë vrasje...”

Siç rezulton nga neni i cituar më lartë, elementet bazike të këtyre veprave penale të rënda janë:

a) vdekja e njeriut si rezultat kriminal ;

b) shkaktuar nga një veprim i caktuar (lidhja shkakore, siç parashihet në nenin 14 KPK); dhe

c) nën rrethanat e parapara nga një apo më shumë prej 12 paragrafëve të nenit 147 të KPK 2003.

Përveç kësaj, elementet tjera janë gjithashtu të nevojshme, siç janë shtuar nga dispozitat e përgjithshme:

d) përgjegjësia penale (veprimi b) më lartë i atribuohet personit me dashje apo nga pakujdesia (neni 11, paragrafi 1 i KPK 2003);

e) në një rëndësi adekuate për të përfunduar dhe me arritë rezultate ligjore, përmbushja (vdekja) apo së paku tentativa e duhur (neni 20 , paragrafi 1 i KPK 2003);

f) kryerja e veprimit b) më lartë, vetëm apo pjesëmarrje e përbashkët në të njëjtin veprim (23 KPK 2003), apo në një nivel më të ulët , duke ndihmuar apo shtyrë dikën që të kryen vepër penale (nenet 24 dhe 25 KPK 2003).

g) Mosekzistimi i cilido prej shkaqeve duke përjashtuar përgjegjësinë penale (njëri prej neneve 7 deri 10, 11. 2 apo 3, 12.1, 18 dhe 19 KPK 2003).

Duke i marrë parasysh të gjitha elementet siç janë paraqitë më lartë dhe faktet e provuara, disa konsiderata ligjore , të cilat qojnë në konkluzionet e duhura, janë si në vijim:

## 1. Vdekja dhe tentativa për të privuar nga jeta e tij apo saj dhe lidhja e saj shkakore

Ndonëse neni 147 CCK 2003 përmend privimin nga jeta e dikujt tjetër si rezultat i zakonshëm i një veprimi kriminal, tentativa për ta kryer gjithashtu është i dënueshëm. Sa i përket nenit 20, ndërmarrja e një veprimi me dashje apo pa dashje, edhe nëse vepra penale nuk është kryer apo elementet e një veprimi të tentuar nuk janë përmbushur, paraqet gjithashtu një mënyrë të kryerjes së veprës penale.

Prandaj, vdekja, si e tillë, nuk është një rezultat i domosdoshëm apo një element esencial i veprës penale në fjalë.

Është dëshmuar se i akuzuari L J ka shtënë në drejtim të së paku dy policëve duke përdorë një pistoletë të llojit "T" kalibri 7.62 x 25mm, numri serik P... dhe në të njëjtin moment dritat janë fikur dhe ai ka ikur në dhomën e fjetjes së fundit të apartamentit, prej nga ai ka shtënë edhe 5 herë tjera në të njëjtin drejtim si më parë.

Gjithashtu është dëshmuar se L J me qëllim ka gjuajtur në drejtim të dy policëve, prandaj ai ka qenë i vetëdijshëm se vdekja mund të paraqitet si një pasojë e ndaluar e veprimit të tij dhe ai përsëri e ka miratuar deri në paraqitjen e tij.

Prandaj, L J ka tentuar të privojë nga jeta së paku dy policë, kështu që me të shtënëit me armë, ai qëllimisht ka kryer një veprim adekuat për të rezultuar me vdekje, i cili nuk ka rezultuar për shkak të rrethanave pavarësisht prej dëshirës së tij dhe jashtë kontrollit të tij.

## 2. Rrethanat rënduese

Në mes të rrethanave tjera të paraqitura, një vrasje është e rëndë kur njëri:

4) Privon nga jeta pesonin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave;

5) Privon nga jeta personin tjetër duke vepruar mizorisht e dhunshëm;

(...)

10) Privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në



mbrojtje të rendit ligjor, sigurimit të njerëzve apo të pasurisë, zbulimit të veprave penale, arrestimit të kryerësit të veprës penale, ruajtjes së personave të privuar nga liria ose ruajtjes së rendit dhe të paqes publike;

*11) Me dashje kryen dy apo me shume vrasje ..."*

Duke e krahasuar numrin 4 dhe 11, me sa duket të dyja zbatohen në rastin aktual në të cilin është dëshmuar se i akuzuari ka shtënë në drejtim të dy policëve me qëllim të privimit të tyre nga jeta. Megjithatë, ato nuk mund të zbatohen së bashku. Në këtë rast, dallimi qëndron te dashja, e cila siç është dëshmuar është drejtuar tek privimi nga jeta e më shumë se një personi, se sa vetëm dashja me e vënë në rrezik jetën e dikujt. Prandaj, trupi gjykues ka vendosë me e ri-kualifikuar paragrafin origjinal 4 të akuzës siç është paraqitë në aktakuzë dhe në vend të tij të zbaton paragrafin 11 për rastin në fjalë.

Përveç kësaj, duke i marrë parasysh faktet siç janë dëshmuar, trupi gjykues i vlerëson faktet që nuk i përbëjnë rrethanat e paragrafit 5. Në të vërtetë, të shtënit 6 herë kundër dy policëve është një sjellje e dhunshme dhe mizore mirëpo jo në atë mënyrë dispropocionale shume me shume se natyra dhunshme dhe mizore e çfarëdo arme tjetër fatale të përdorur në mënyrë të zakonshme. Situata do të ishte më ndryshe në të cilën të gjitha të shtënat (dhe përdorimi i RPG) do të mund t'i atribuohet të akuzuarit, gjë që nuk është dëshmuar. Prandaj, trupi gjykues ka vendosë që paragrafi 5 nuk është i zbatueshëm në rastin në fjalë.

Përfundimisht, trupi gjykues ka konsideruar si shumë të zbatueshëm paragrafin 10, si një rrethanë tjetër rënduese, siç është dëshmuar se i akuzuari ka vepruar në kohën kur policët ishin duke e kryer detyrën e tyre për të mbrojtur rendin publik, duke i zbuluar veprat penale, duke e kapë kryesin e veprës penale dhe duke e mbajtur rendin dhe qetësinë publike.

### 3. Dashja kriminale specifike

Në bazë të nenit 15 KPK 2003, dashja mund të jetë direkte ose eventuale. Dashja (*mens rea*) si një element i pastër subjektiv mund të veçohet vetëm nga një numër i

fakteve objektive si tërësi, e prekur nga mendimi i zakonshëm dhe dijenia e zakonshme e natyrës së njeriut.

Trupi gjykues e ka kuptuar se dashja kryesore e të akuzuarit ka qenë ikja/ të mos kapet; por ai gjithashtu e ka respektuar shumë se vdekja e policëve kundër të cilëve ka shtënë ka mundur të rezultojë nga të shtënat dhe ai e ka miratuar mjaft rezultimin e tij. Në fakt, ikja në dhomën e fjetjes së pari dhe ikja nga apartamenti më vonë, por të shtënit kundër policëve, është një veprim i tërë i cili përfshin medoemos një rrezik serioz dhe të vetëdijshëm të privimit nga jeta të caktit, si një veprim adekuat për të shkaktuar vdekjen direkt. Përveç kësaj, siç është dëshmuar, L. J. ka shtënë kundër së paku dy policëve para se me ikë brenda dhomës së fjetjes dhe dritat janë shkyçë. Kjo nënkupton se ai ka mundur ta ndërton qëllimin e tij vetëm mbi dy viktima. Çfarëdo e shtënë tjetër nga dhoma e fjetjes, duke marrë parasysh se nuk ka pasur drita, nuk ka mundur të rritë numrin e viktimave të paraqitura se sa numri i viktimave që i ka paraqitë në fillim të shtënave. Dikush mund të argumenton se ai ka mundur të parashikon se aty kanë qenë prezent më shumë se një polic në vendin e ngjarjes më vonë, gjë që mund të kualifikohet si sjellje nga pakujdesia. Megjithatë, tentativa dhe pakujdesia nuk përputhen fare.

Sa i përket kualifikimit ligjor të dashjes, një lloj i tillë nuk është më e madhe (që kishte për pasur qëllim të drejtpërdrejt t'i vras këto viktima në veçanti) por gjithashtu nuk është dashje me e vogël (vrasja e mundshme e viktimave marrë së bashku me ikjen dhe shmangien nga policia). Ky qëllim i nivelit të mesëm (zakonisht i quajtur *dolus e nevojshme*) nuk parashihet me KPK 2003. Megjithatë, intensiteti i saktë i këtij *dolus*, ndonëse nuk e mohon ekzistimin e tij si dashje e vërtetë, konsiderohet nga trupi gjykues gjatë caktimit të dënimit.

#### 4. Mungesa e pjesëmarrjes së përbashkët (bashkë-kryerjes )

Neni 23 e përcakton bashkëkryerjen si PJESËMARRJE E PËRBASHKËT e një apo më shumë personave në kryerjen e veprës penale.

Dallimi në mes të pjesëmarrjes dhe pjesëmarrjes së përbashkët qëndron saktësisht në dashjen që gjithmonë është kufiri i përgjegjësisë individuale (neni 27, paragrafi 1 i KPK 2003).

Pjesëmarrje e përbashkët nënkupton një dashje të përbashkët, ose përmes planit të mëhershëm të përbashkët ose së paku nënkuptim i zbatimit të mëvonshëm të atij plani.

Dy persona, edhe nëse veprojnë ngjashëm dhe të shoqëruar së bashku, duke pas për qëllim të njëjtin për secilin prej tyre, nuk përbën një veprim të përbashkët.

Në këtë rast në fjalë, është dëshmuar se L J ka vepruar menjëherë kundër veprimit të policëve të cilët kanë hyrë në apartament, duke shtënë në drejtim të tyre. Në asnjë moment nuk është dëshmuar se Xh Sh , në atë moment të caktuar brenda mesit të dhomës, është pajtuar më herët me të akuzuarin për t'i ndihmuar atij ose me vepruar me qëllim të përbashkët për të ikur nga të dyja, nga apartamenti apo me i vra policët kur i kanë parë. As nuk është dëshmuar se të dy kanë ikur nga apartamenti njëkohësisht kudo në të njëjtin vend. Prandaj, trupi gjykues ka vlerësuar se faktet aktuale nuk e përbëjnë në mënyrë të mjaftueshme një dashje të përbashkët dhe të njëjtë që do ta bënte L J përgjegjës për të shtënë në përgjithësi, duke përfshirë atë të shtënë nga Xh Sh , në mënyrën e saktë siç është prodhuar. Prandaj, trupi gjykues konsideron se nuk është dëshmuar veprimi i duhur i përbashkët në mënyrë që të konfigurohet si koncept ligjor i bashkë kryerjes.

#### 5. Mungesa e mbrojtjes së nevojshme dhe mungesa e lajthitjes faktike

Në bazë të nenit 8 KPK 2003, mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm. Sulmi siç është idealizuar dhe vendos në veprim nga njësia e policisë, mënyra e saktë është konsideruar se është dëshmuar, se ishte çdo gjë përveç i kundërligjshëm, duke marrë parasysh qëllimet ligjore të cilat janë dëshmuar gjithashtu. Kjo arsye është e nevojshme për të përjashtuar çdo mbrojtje të nevojshme, duke qenë mos ekzistuese në bazë të kërkesave bazike.

I ashtuquajtur lajthimi faktik siç parashihet me nenin 18, paragrafi 1 KPK 2003, nënkupton se kryesi nuk ka qenë i vetëdijshëm për ndonjë nga tiparet e asaj vepre ose gabimisht ka menduar se ekzistonin rrethanat, të cilat faktikisht po të ekzistonin, kjo vepër do të ishte e lejuar.

Sjellja në vetëmbrojtje siç është paraqitë nga L J është bazuar në perceptimin e gabuar të deklaruar dhe vetëbindjen se njësia e policisë ishte më shumë një grup i Agim Krasniqit, grup rival i cili gjoja sikur kanë dashur ta vrasin. Kjo përbën një lajthim faktik, duke qenë se ky fakt ka qenë një situatë e tërë e mbrojtjes së nevojshme. Siç është shpjeguar më herët, kjo mënyrë e të argumentuarit është konsideruar si plotësisht e paarsyeshme prandaj edhe e pavërtetë, në paaftësi për të ngritë çfarëdo dyshimi serioz apo të besueshëm në trupin gjykues. Në të vërtetë, policët i kanë respektuar të gjitha procedurat dhe standardet e një operacioni; ata i kanë përdorë edhe jelekët e operativës dhe mburojat me emrin e shtypur Policia; L J kërkohet nga Interpoli për shkak të urdhër arresteve në pritje duke i dhënë atij arsye për t'ia mbathur nga policia; një vëzhgues i zakonshëm, në këtë rast i përfaqësuar nga të dy V A dhe F S menjëherë e kanë parë grupin si zyrtarë të policisë, pas asnjë dyshim; dhe përfundimisht, në asnjë çast gjatë të shtënave L J nuk është munduar të zhvillon një bisedë gojore të pritshme dhe të qartësimit brenda dhomës së fjetjes, ku edhe kishte ikur. Në vend të kësaj ai vetëm kishte shtënë me armë dhe kishte ikur në Kosovë.

Në përfundim, L J i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore dhe prandaj e ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, në shkelje të nenit 147, paragrafët 10 dhe 11 të KPK 2003.

#### 6. Vrasje e rëndë si në KPK 2013 të ri CCK 2013 (Ligjit 04/L-082)

Akuza 6, e kualifikuar si vrasje e rëndë në aktakuzë, duhet të filtrohet ende se me cilin nen 2, paragraf 2 të KPK 2003 e cakton, më vonë të paraparë me nenin 3, paragrafin 2 të KPK të ri të 2013-tës; ligji më i favorshëm duhet të aplikohet.

Duke i krahasuar të dy Kodet, jo vetëm që dënimi është i njëjtte plotësisht por gjithashtu edhe rrethanat rënduese në fjalë janë të njëjta gjithashtu: ku aty kishin qenë paragrafët 10 dhe 11 të nenit 147 KPK 2003, tani janë përkatësisht 1.9 dhe

1.11 i nenit 179 KPK 2013. Prej së cilës sa i përket dispozitave dhe dënimeve abstrakte Kodi i ri është më i favorshëm se sa i vjetri.

B) Akuza 8 - Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare (nenet 317, § 1 dhe 3, dhe 23 KPK 2003)

Duke e konsideruar dashjen për të vrarë siç është dëshmuar- më shumë se sa sulmi i personit zyrtar – në një rreth të anë; dhe rrethanën rënduese siç është paraparë në paragrafin 10 të nenit 147 KPK 2003 të “privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në mbrojtje të rendit ligjor, sigurimit të njerëzve apo të pasurisë, zbulimit të veprave penale, arrestimit të kryerësit të veprës penale, ruajtjes së personave të privuar nga liria ose ruajtjes së rendit dhe të paqes publike”, në anën tjetër, “person zyrtar gjatë kryerjes së detyrës së tij/saj zyrtare” është tashmë një rrethanë materiale njëherësh pasi të merret parasysh mbi të njëjtat fakte, e njëjta rrethanë nuk mund të konsiderohet në dyfish, pasi që në rastin në fjalë, sulmi është i nevojshëm dhe mënyra adekuate për të prodhuar rezultate ligjore (privimi nga jeta). Prandaj, i vetmi përfundim i mundshëm është që akuza 8 duhet të konsumohet plotësisht nga akuza 6 dhe nuk mundet përndryshe të konsiderohet dhe dënohet në mënyre të pavarur, pa asnjë konsideratë tjetër këtu të konsideruar si të nevojshme.

C) Akuza 9 – Mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në bashkëkryerje (nenet 328, § 1 dhe 2, dhe 23 i KPK 003)

L J është akuzuar për të dyja nën 1/përdorim dhe 2/kontroll, posedim ose përdorim të armëve, sa i përket të dy paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 328 KPK 2003, në bashkëkryerje me një individ tjetër.

Është dëshmuar se L J së bashku me Xh Sh kanë sjellë në apartament në T një numër të pacaktuar të armëve, të cilat së paku kanë përfshirë një pistoletë të llojit “T” i kalibrit 7.62 x 25mm, me numër serik P..., me një fishek të gjetur në dhomëz, 256 fishekë të përmbajtur në 15 pako, 8 karikator për armë zjarri të cilat përmbanin një total prej 180 fishekëve, 54 fishekëve për llojin W të kalibrit.308, një lansues të granatës MGL-6 numri serik është hequr, një pushkë zjarri C Z M92, të kalibrit 7.62 x 39m, me numrin serik 7685, dhe një pushkë zjarri të paidentifikuar të kalibrit 7.62 x

39mm dhe 6 granata, të cilave ju janë shtuar siç duhet edhe sasia e municionit të lartshënuar të cilat janë dëshmuar se janë shkrepur.

Përveç kësaj, është dëshmuar se në kohën kur ai e ka përdorë pistoletën "T " dhe kanë poseduar pjesën e mbetur të armëve, L J ka vepruar kështu pa pasur në fuqi një autorizim të valid apo certifikatë për armëmbajtje për këto armë.

Shkurtimisht, L J ka përdorë pistoletën e llojit T me numër identifikues si më lartë gjatë të shtënimit me armë kundër së paku dy policëve. Kjo plotësisht e tipizon përshkrimin e nenit 328, paragrafi 1 KPK 2003; përveç kësaj ai ka poseduar dhe kontrolluar listën e lartpërmendur me armë përderisa i ka sjellë të gjitha ato në apartament së bashku me Xh Sh , pa qenë i autorizuar në mënyrë të duhur për të vepruar kështu, në të cilën listë gjithashtu është përfshirë posedimi i paautorizuar dhe kontrollimi i pistoletës së llojit T . Duke vepruar kështu, veprimi i tij gjithashtu e tipizon plotësisht paragrafin 2 të të njëjtit nen të KPK-së 2003.

Trupi gjykues, është plotësisht i vetëdijshëm se si kualifikimi i diskutuar është vrasja e rëndë a e konsumon apo jo veprën penale të përdorimit të një arme të caktuar të nevojshme për të kryer vrasjen e rëndë në fjalë.

Në njërin anë, vlera e mbrojtur në fjalë është ndryshe pasi që Vrasja e mbron jetën e njeriut dhe përdorimi i paautorizuar i armëve e mbron rendin publik; në anën tjetër, ligjvënësi kur e dënon përdorimin e paautorizuar të armëve e ka konsideruar si asgjë por mënyrë për të parashikuar mbrojtjen e vërtetë nga rezultatet kriminale – ato të cilat në fund të fundit duhet të parandalohen. Me fjalë tjera, ndonjëherë dënimi i veprimeve të caktuara ia vlen për qëllimin e thjeshtë të mbrojtjes nga rezultate tjera të dëmshme përkundër faktit edhe nëse nuk janë të përfshira si elemente të vet veprës penale. Në rastin në fjalë, dënimi i përdorimit të paautorizuar të armëve do të ishte në parim për të mbrojtur nga rezultatet e dëmshme të cilat janë në gjendje të shkaktojnë ato armë kur të përdoren. Duke e pasur këtë, rezultati i synuar është dëmtuar në efekt (tentim vrasja e rëndë), përdorimi i një mjeti, i marrë për të përdorë një rezultat të tillë do të konsumohej nga vepra penale thelbësore, në rast të tentim vrasjes.

Trupi gjykues ka zgjedhur këtë të fundit.

Megjithatë, gjithmonë mbetet vepra penale e posedimit të paautorizuar dhe kontrollit të armëve në lidhje me listën e plotë të armëve të identifikuara më lartë, në të cilën është përfshirë pistoletë e llojit T .

Në bazë të nenit 2, paragrafi 1 i Ligjit 04/L-209 mbi Amnisti të datës 11 korrik 2013, të gjithë kryesit e veprave penale të paraqitur më poshtë në nenin 3 të këtij Ligji, të cilat janë kryer para datës 20 qershor 2013, do të jenë të liruar plotësisht nga ndjekja penale ose nga ekzekutimi i dënimeve për vepra të tilla penale, në pajtim me kushtet dhe termet e të njëjtit nen.

Vepra penale e posedimit të paautorizuar dhe kontrollit të armëve janë paraqitur në mesin e atyre të cilat i nënshtrohen amnistisë aktuale si në nenin 3.1.2.5 të atij Ligji. Pasi që nuk është dëshmuar asnjë vepër penale "e cila ka rezultuar me lëndime të rënda trupore ose vdekje", si në nenin 4.1.3, as përdorimi i dëshmuar i pistoletës së llojit Tokarev, nuk do të ishte një përjashtim nga amnistia e lartpërmendur dhe prandaj nuk ka përjashtim as në këtë rast.

E vetmja çështje e diskutuar në lidhje me zbatimin efektiv të amnistisë së përmendur për veprat penale në fjalë do të ishte neni 1 i të njëjtit ligj: thuhet shprehimisht se vlen për "ndjekjen penale të atyre veprave penale të cilat janë kryer para 20 qershorit 2013 BRENTA territorit që tani e përbën Republikën e Kosovës".

Rasti në fjalë është kryer JASHTË territorit që tani e përbën Republikën e Kosovës, domethënë në XXX, Tetovo, Maqedoni .

I vetëdijshëm për këtë, trupi gjykues ka gjetur se duke qenë një kusht për ndjekje "vepra duhet me qenë GJITHASHTU e dënueshme në vendin e kryerjes", megjithatë ligji i zbatueshëm (në tërësinë e tij) në Kosovë është i vetmi (neni 101, paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së 2013 dhe neni 115, paragrafi 3 i KPK-së 2012).

Ndonëse Kosova nuk mund të përcakton amnistinë në bazë të veprave të kryera në shtetet e tjera, për shkak të mungesës së sovranitetit mbi shtetet e tilla, veprimi i

ndjekjes penale në Kosovë të një veprë e cila është kryer jashtë Kosovës nga një shtetas i Kosovës kur në rastin e ngjashëm është kryer brenda Kosovës, ndjekja penale e të njëjtës veprë do të ndalej me doemos me amnisti (pa qenë veprë penale e cila ndiqet penalisht në Kosovë si kushti i parë), pastaj do të përbente shkeljen kundër sovranitetit: Kosova do ta pranonte vlerën e cila i atribuohet veprave të tilla të një natyre kriminale ose jo nga një shtet tjetër në dëmin e vlerës së vet Kosovës.

Prandaj, trupi gjyqësor ka përfunduar se përkundër asaj që amnistia nuk mund të shpallet mbi aktet e kryera jashtë Kosovës për shkak të arsyeve të sovranitetit të përbashkët të shteteve, duhet megjithatë të zgjerohet deri te çfarëdo ndjekje penale në Kosovë në bazë të fakteve të ngjashme pasi që fillimisht veprat penale në fjalë duhet të jenë krime brenda Kosovës. Kriteri i censurës së një veprë penale duhet të jetë e dënueshme GJITHASHTU edhe në vendin ku është kryer, që e përcakton mundësinë e parë të ndjekjes penale dhe të dënimit të një akti në Kosovë, veçanërisht pasi që nuk mund të qëndrojë në pajtim ekskluziv me kriteret e shteteve të huaja. Në raste të tilla, kriteret e Kosovës duhet të mbizotërojnë.

## **CAKTIMI I DËNIMIT**

Sa i përket nenit 3.2 të KPK të ri, si dhe nenit 2, paragrafi 2 i ish KPK, ligji më i favorshëm do të aplikohet, që nënkupton, si parim të dyja edhe llogaritja e dënimeve dhe një analize e detajuar e regjimeve abstrakte globale.

Në bazë të nenit 34.1 dhe 2 të ish KPK, dënimet të cilat duhet të caktohen paraqesin tri qëllime të ndryshme dhe kumulative: për të parandaluar kryesin me kryer vepra penale në të ardhmen, për të rehabilituar atë dhe t'i ndaloj personat tjerë që të kryejnë vepra penale. Neni 41 i KPK të ri paraqesin dy qëllime të reja të cilat duhet të merren në konsideratë në përgjithësi, së bashku me të përmendurit këtu.

Në lidhje me llogaritjen e dënimeve, neni 64.1 i ish KPK i ka përcaktuar kriteret të cilat duhet të konsiderohen, kufijtë dhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Neni 73 i



KPK-së nuk e përcakton një sistem të ndryshëm dhe gjithashtu rrethanat rënduese dhe lehtësuese duhet të merren parasysh në të njëjtën mënyrë.

Neni 71 i ish KPK dhe neni 80 i KPK të ri përcaktojnë të njëjta kriteret e dënimeve. Duhet të theksohet se asnjëri prej regjimeve të definuar nuk mund të konsiderohen shkurtimisht dhe në konspekt si më të favorshëm apo pafavorshëm për personin e dënuar, duke i konsideruar vetëm kornizat abstrakte të dënimeve. Prandaj ky operacion përfundues do të zbatohet në bazë të rrethanave konkrete të përfshira. Prandaj,

Për vrasje të rëndë, neni 147 i KPK (2003) parasheh,

“Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili:

(...)

10) Privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në mbrojtje të rendit ligjor, sigurimit të njerëzve apo të pasurisë, zbulimit të veprave penale, arrestimit të kryerësit të veprës penale, ruajtjes së personave të privuar nga liria ose ruajtjes së rendit dhe të paqes publike;

11) Me dashje kryen dy apo më shumë vrasje ...”

Neni 179 KPK (2012) përcakton saktësisht të njëjtën kornizë të dënimeve si dhe të njëjtat rrethana rënduese në fjalë- paragrafi 1.9 i referohet privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare; dhe paragrafi 1.11 i referohet kryerjes me dashje të një apo më shumë vrasjeve.

Në kuptim abstrakt nuk ka dallim relevant në mes të dy regjimeve të dënimeve siç parashihet. Megjithatë, i tërë regjimi duhet të merret parasysh.

Sa i përket kësaj çështjeje në veçanti, për formën e tentuar të kryerjes së krimit, ekzistojnë dallime thelbësore të cilat medoemos ndikojnë në rezultatin final të dënimit.

Në të vërtetë, sa i përket nenit 20 të KPK (2003), paragrafi 3, “ Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet më butë se sa kryerësi, në pajtim me nenin 65, paragrafi 2 të këtij Kodi”

Neni 65, paragrafi 2 i Kodit të lartpërmendur , parasheh: “Dënimi i shqiptuar për tentativë, për ndihmë dhe për bashkim kriminal nuk duhet të jetë më i lartë se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për vepër penale”. Më tutje, neni 66, paragrafi 1 parasheh që “gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit:... kur ligji parasheh se dënimi i kryerësit mund të zbutet”.

*Në një interpretim të përbashkët të dy neneve 20 dhe 66, mundësia e zbutjes së dënimit shndërrohet në detyrues. Përndryshe detyrimi për të dënuar kryesin më butësisht siç parashihet me nenin 2, paragrafin 3 do të shkelej nëse nuk do të zbatohet medoemos.*

Duke i zbatuar kufijtë e zbutjes siç parashihen me nenin 67, paragrafi 1.3 në lidhje me nenin 65, paragrafi 2 i KPK –së (2003), korniza e zbutur e dënimit do të ishte për veprën penale të vrasje së rëndë në tentative në fjalë, nga 1 deri në 30 vjet burgim.

KPK-së (2012), parasheh dënimin e çfarëdo tentative në një mënyrë më të rëndë. Vërtetë, neni 28, paragrafi 3 parasheh : “Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet.”

Duke i krahasuar të dy regjimet , dënimi MUND TË reduktohet në pajtim me kodin e ri, por është e detyrueshme që të zbutet në pajtim me të vjetrin.

Në anën tjetër, edhe nëse zbutet në pajtim me Kodin e ri, si në nenin 76, paragrafi 1.1, për veprën penale në fjalë , koha minimale e burgimit që duhet të caktohet konkretisht nuk duhet të jetë nën 5 vjet burgim. Në bazë të ish Kodit (2003) koha minimale është më e ulët se kjo, siç është paraqitë më herët.

Në përfundim, ish Kodi KPK (2003) është medoemos më i favorshëm se sa i riu dhe do të zbatohet për rastin në fjalë.

*Neni 64 KPK (2003), Kodi i zbatueshëm këtu, parasheh që gjykata do të merr parasysh “(...) qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit dhe në (rrethanat letësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën*

e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit”.

Në njërën anë, trupi gjykues ka pasur parasysh shkallën mesatare të përgjegjësisë së tij penale: dashja nuk është e nivelit më të lartë për të arrite një *dolus* direkt dhe tipik por megjithatë e tejkalon *dolusin* eventual, pasi që privimi nga jeta ka qenë më shumë se sa thjeshtë por fuqimisht e mundshme si pasojë e kësaj; si dhe intensiteti i rrezikut apo i lëndimit i vlerës së mbrojtur që është e lartë sa 6 të shtëna të gjuajtura të drejtim të dikujt është e një natyre më të lartë. Prandaj, trupi gjykues e ka vlerësuar se dënimi konkret nuk mund të jetë më i ulët se 5 vjet burgim.

Në anën tjetër, rëndesa e veprës penale duke marrë parasysh pasojat e padëshmuara siç janë lëndimet e rënda, atëherë duhet të konsiderohet si e ulët; arsyet për të kryer aktin nuk janë ligjërisht të pranueshme, pasi që nëse nuk kapesh nga policia nuk mund të konsiderohet si një rrethanë lehtësuese fare. Përveç kësaj, rrethanat e veprës kanë zbuluar se nuk ka pasur paramendim por në vend të kësaj një reagim të atëçastshëm. Koha e kaluar që nga ngjarja gjithashtu llogaritet në favor në pandehurit. Përfundimisht në lidhje me sjelljen në të kaluarën të kryesit, nuk janë gjetur dënime të mëhershme dhe e vetmja ndonëse i referohet fakteve prej datës 2000, e përcaktojnë censurën ligjore të natyrës së saj vetëm në vitin 2007 kur është lëshuar vendimi. Të gjitha dënimet e tjera të raportuara ishin në mungesë dhe ato nuk mund të konsiderohen si valide në pajtim me ligjin në Kosovë për të gjitha ndikimet e mundshme. Prandaj, trupi gjykues e ka vlerësuar se dënimi konkret nuk mund të jetë më i lartë se 7 vjet burgim.

Duke i marrë parasysh të gjitha ato rrethana , Gjykata gjen se **6 (gjashtë) vjet burgim** është dënimi adekuat.

## KËRKESA PËR KOMPENSIM

Për shkak të faktit se viktimat janë prej një shtetit të huaj, shumica prej tyre të mbrojtura në anonimitet, duke qenë pjesë e fakteve të njëjta, të cilat i janë nënshtruar më herët gjykimit në Tetovë, duke marrë parasysh se i pandehuri ndodhet në paraburgim dhe duke e balancuar afatin kohor të një gjykimi të shpejtë siç është kërkuar dhe aktet e provave që duhet ende të grumbullohen të gjitha faktet në lidhje me kërkesat e mundshme për kompensim, trupi gjykues ka vendosë që t'i referon viktimat tek instancat e duhura civile në mënyrë që kërkesa për kompensim të jetë më efektive.

Duke i marrë parasysh të gjitha bazat e përmendura më lartë, është vendosë si në dispozitiv.

**Mjetet ligjore:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesa nga Prokuroria ose nga të pandehurit e dënuar para Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore në Gjilan brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur është pranuar aktgjykimi i plotë me shkrim nga palët, në bazë të nenit 380, paragrafi 1, 381, paragrafi 1 dhe 388, paragrafi 1, të gjitha nga KPPK.

Gjilan, 14 dhjetor 2015

Vitor Hugo Pardal  
Kryetar i trupit gjykues

Muhamet Musliu  
Procesmbajtës